



Drejtoria e Përgjithshme e
Shërbimeve të Transportit Rrugor

MANUAL

**PËR KONTROLLIN E NJOHURIVE TEORIKE TË
KANDIDATËVE PËR LEJE DREJTIMI TË KATEGORIVE**

A1, A2, B1, B



STRUKTURA E TESTIT TEORIK PËR LEJEDREJTIMI TË KATEGORIVE A1, A2, B1 DHE B

Tema	Përmbajtja e temës	Fjali në test	Fjalja 1	Fjalja 2
1	Sinjalet e rrezikut.	2	1 - 157	158 - 293
2	Sinjalet e ndalimit.	2	294 - 374	375 - 476
3	Sinjalet e detyrimit.	2	477 - 517	518 - 572
4	Sinjalet e përparësisë.	2	573 - 615	616 - 656
5	Sinjalet horizontale dhe sinjalet qe tregojnë pengesa.	2	657 - 811	812 - 968
6	Sinjalet semaforike dhe te policëve te trafikut.	2	969 - 1026	1027 - 1088
7	Kufijtë e shpejtësisë, rreziku ne trafikun e ngarkuar, sjellja ne kalimet ne nivel.	2	1089 - 1136	1137 - 1173
8	Distanca e sigurisë, parimet me te rëndësishme në lidhje me respektimin e një distance të sigurt mes mjeteve, distancat e frenimit dhe zotërimi i rrugës në gjendje të ndryshme, si dhe të kushteve të motit, faktorët e rrezikut të drejtimit që kanë lidhje me kushtet e ndryshme të rrugëve, veçanërisht nëse ato ndryshojnë sipas motit dhe kohës, ditë apo natë.	2	1174 - 1212	1213 - 1245
9	Rregullat e qarkullimit të mjeteve. Pozicioni i mjeteve në karrexhatë. Ndryshimi i drejtimit të lëvizjes (kthimi). Sjellja në prani të funeraleve, kortezheve dhe kolonave ushtarake. Sjellja ne kryqëzime. Rregullat e përparësisë. Detyrimet kundrejt mjeteve te policisë dhe te urgjencës. Rreziqet e lidhura me manovrat, me drejtimin e tipave te ndryshëm te mjeteve dhe me fushëpamjen e kufizuar te drejtuesit te mjetit.	2	1246 - 1369	1370 - 1473
10	Shembuj të përparësisë (rregullat e përparësisë ne kryqëzime).	2	1474 - 1658	1659 - 1860
11	Rregullat e parakallimit.	2	1861 - 1916	1917 - 1973
12	Rregulla të ndryshme, si: - zënia e karrexhatës; - sinjalizimi i mjetit te ndaluar; - rregullat e qarkullimit në autostradë dhe rrugë interurbane kryesore; - transporti i udhëtareve; - ngarkesa e mjeteve; - panelet mbi mjete; - tërheqja e mjeteve ne avari; - tërheqja e rimorkiove;	2	1974 - 2014	2015 - 2060
13	Sistemet e pajimit, funksioni dhe përdorimi; Rripat e sigurimit dhe sistemet e fiksimit për fëmijët; Kaska mbrojtëse dhe veshjet e sigurisë;	2	2061 - 2075	2076 - 2124



14	Sjelljet për parandalimin e aksidenteve rrugore; Sjellja në rast të aksidenteve rrugore, kujdesi gjatë drejtimit të motorëve.	2	2125 - 2145	2146 - 2194
15	Kuptimi, gjykimi dhe vendimmarrja, në veçanti koha e reagimit, si dhe ndryshimet në sjelljen e drejtimit të mjetit nën ndikimin e alkoolit, drogës dhe medikamenteve mjekësore, gjendjes mendore dhe lodhjes.	2	2195 - 2221	2222 - 2245
16	Përkufizimet rrugore dhe të trafikut. Përkufizimet dhe klasifikimi i mjeteve. Detyrat e drejtuesve të mjeteve në përdorimin e rrugës. Bashkëpunimi civil dhe përdorimi i rrugës me përgjegjshmëri. Kujdesi kundrejt përdoruesve të dobët të rrugës (të moshuarve, invalidëve, fëmijëve, këmbësorëve, çiklistëve).	1	2246 - 2435	
17	Sinjalet treguese.	1	2436 - 2837	
18	Sinjalet plotësuese. Sinjalet e përkohshme të kantierit	1	2838 - 2937	
19	Panelet plotësuese.	1	2938 - 3073	
20	Ndalimi, qëndrimi, pushimi dhe nisja.	1	3074 - 3209	
21	Përdorimi i dritave, pajisjeve akustike, llambave spine dhe simboleve.	1	3210 - 3322	
22	Lejedrejtimi. Dokumentet e qarkullimit të mjetit. Targat e mjeteve. Detyrimi kundrejt funksionarëve dhe agentëve të policisë. Sanksionet. Lejedrejtimi me pikë. Përdorimi i lenteve dhe aparateve të tjera.	1	3323 - 3444	
23	Përgjegjësia civile, penale dhe administrative, sigurimi i detyrueshëm dhe sigurimet e tjera ligjore të mjetit.	1	3445 - 3477	
24	Kufizimi i konsumit. Respektimi i mjedisit. Ndotja atmosferike, akustike dhe nga hedhjet e mbeturinave.	1	3478 - 3523	
25	Elementet përbërëse të mjetit, rëndësia e tyre për sigurinë. Mirëmbajtja dhe përdorimi i mjetit. Stabiliteti i mjetit në lëvizje. Sjellja e kujdeseshme në qarkullim.	1	3524 - 3665	
Shuma e fjalive në test		40		



Sqarime:

- *Temat e programit dhe struktura e testit janë të përcaktuara në Udhëzimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 682/4, datë 1.4.2016 "Për aktivitetin e autoshkollave, pajisjen e kandidatëve me lejedrejtimi, kualifikimin e instruktorëve të autoshkollave dhe specialistëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR)".*
- *Testi teorik përmban 40 fjali pohore të përzgjedhura sipas temave nga fjalitë bashkëlidhur.*
- *Nga tema 1 deri tek tema 15 përzgjidhen nga dy fjali për teme dhe nga tema 16 deri tek tema 25 përzgjidhet një fjali për temë.*
- *Në kolonën "Përgjigja" është dhënë opsioni korrekt i vlerësimit të fjalisë, përzgjedhja e të cilit vlerësohet me një pikë.*
- *Kandidati shpallet fitues i testit teorik kur ka fituar jo më pak se 36 pikë.*



FJALI PËR KONTROLLIN E NJOHURIVE TEORIKE TE KANDIDATEVE PËR LEJEDREJTIMI TË KATEGORIVE A1, A2, B1, B

Nr.	Përmbajtja e fjalisë	Figura	Përgjigja
1	Sinjali në figurë, si rregull, në rrugë interurbane është 150 metër para pjesës ku fillon deformimi i rrugës.	1	Saktë
2	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge të deformuar.	1	Saktë
3	Në prani të sinjalit në figurë duhet të lëvizet me kujdes, sidomos kur rruga është e rrëshqitshme.	1	Saktë
4	Sinjali si në figurë paralajmëron rrugë të deformuar pas një distance prej 320 metër.	900	Saktë
5	Sinjali si në figurë paralajmëron rrugë të deformuar për shkak të punimeve.	901	Saktë
6	Sinjali në figurë paralajmëron një pjerrësi të rrezikshme.	1	Gabim
7	Sinjali në figurë paralajmëron një ndryshim të fortë të pjerrësisë së rrugës.	1	Gabim
8	Sinjali në figurë paralajmëron një kthesë të dyfishtë.	1	Gabim
9	Sinjali në figurë është një sinjal vertikal që paralajmëron rrezik.	2	Saktë
10	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge me fushëpamje të kufizuar.	2	Saktë
11	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge që është në formë kurrizi.	2	Saktë
12	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge që është në ngjitje dhe pastaj në zbritje.	2	Saktë
13	Në prani të sinjalit në figurë, në një rrugë me një korsi për çdo sens lëvizje, ndalohet parakalimi në pjesën e përpjetë të rrugës.	2	Saktë
14	Në prani të sinjalit në figurë ndalohet qëndrimi i mjetit në pjesën ngjitëse dhe zbritëse të rrugës.	2	Saktë
15	Në prani të sinjalit në figurë, në një rrugë me një korsi për çdo sens lëvizje, duhet të ulni shpejtësinë dhe të spostoheni në anën e djathtë të karrexhatës.	2	Saktë
16	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge të deformuar.	2	Gabim
17	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge të dëmtuar.	2	Gabim
18	Sinjali në figurë, ndalon parakalimin në ngjitje dhe zbritje të kurrizit.	2	Gabim
19	Sinjali në figurë paralajmëron punime në rrugë.	2	Gabim



20	Sinjali në figurë është një sinjal vertikal që paralajmëron rrezik.	3	Saktë
21	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge në formë të lugët (zbritje dhe ngjitje).	3	Saktë
22	Në prani të sinjalit në figurë lejohet parakalimi, por me kujdes dhe sipas rregullave.	3	Saktë
23	Sinjali në figurë paralajmëron mundësinë e formimit të pellgjeve të ujit në raste shiu.	3	Saktë
24	Në prani të sinjalit në figurë duhet të zvogëlojmë shpejtësinë e lëvizjes për shkak të formës së lugët të rrugës.	3	Saktë
25	Sinjali në figurë paralajmëron bankina rrugore të dëmtuara.	3	Gabim
26	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge të dëmtuar.	3	Gabim
27	Sinjali në figurë paralajmëron një rrugë me gjendje të keqe të asfaltit.	3	Gabim
28	Sinjali në figurë paralajmëron një ngushtim të karrexhatës.	3	Gabim
29	Sinjali në figurë paralajmëron një kthesë të rrezikshme, djathtas.	4	Saktë
30	Në prani të sinjalit në figurë ndalohet ndryshimi i sensit të lëvizjes së mjetit.	4	Saktë
31	Në prani të sinjalit në figurë ndalohet qëndrimi apo pushimi i mjetit.	4	Saktë
32	Sinjali në figurë ndalon lëvizjen prapa (indietro).	4	Saktë
33	Në prani të sinjalit në figurë duhet të rrisim shpejtësinë e lëvizjes.	4	Gabim
34	Sinjali në figurë paralajmëron disa kthesa, ku e para fillon nga e djathta.	4	Gabim
35	Në prani të sinjalit në figurë lejohet pushimi i mjetit në kthesë.	4	Gabim
36	Sinjali në figurë paralajmëron një degëzim dhe detyron kthimin djathtas.	4	Gabim
37	Sinjali në figurë paralajmëron ndryshim korsie.	4	Gabim
38	Në prani të sinjalit në figurë lejohet parakalimi i mjeteve edhe pse rruga është e ngushtë.	4	Gabim
39	Sinjali në figurë është një sinjal vertikal që paralajmëron rrezik.	5	Saktë
40	Sinjali në figurë, si rregull, në rrugë interurbane është i vendosur 150 metër para kthesës së rrezikshme.	5	Saktë



41	Sinjali në figurë paralajmëron një kthesë të rrezikshme, majtas.	5	Saktë
42	Në prani të sinjalit në figurë duhet zvogëluar shpejtësia e lëvizjes së mjetit.	5	Saktë
43	Në prani të sinjalit në figurë ndalohe ndryshimi i sensit të lëvizjes.	5	Saktë
44	Në prani të sinjalit në figurë ndalohe qëndrimi i mjetit në kthesë.	5	Saktë
45	Në prani të sinjalit në figurë ndalohe lëvizja prapa (indietro).	5	Saktë
46	Sinjali në figurë paralajmëron rënie gurësh nga e djathta.	5	Gabim
47	Sinjali në figurë lejon ndryshimin e sensit të lëvizjes.	5	Gabim
48	Sinjali në figurë paralajmëron ngushtimin e rrugës nga krahu i majtë.	5	Gabim
49	Sinjali në figurë paralajmëron se po i afrohem një rrethqarkullimi.	5	Gabim
50	Sinjali në figurë paralajmëron kthesa të rrezikshme dhe të njëpasnjëshme, prej të cilave kthesa e parë është djathtas.	6	Saktë
51	Sinjali në figurë paralajmëron 3 (tre) kthesa të rrezikshme prej të cilave e para është djathtas.	902	Saktë
52	Në prani të sinjalit në figurë duhet zvogëluar shpejtësia e lëvizjes së mjetit.	6	Saktë
53	Në prani të sinjalit në figurë ndalohe ndryshimi i sensit të lëvizjes së mjetit.	6	Saktë
54	Në prani të sinjalit në figurë ndalohe qëndrimi apo pushimi i mjetit në kthesa.	6	Saktë
55	Në prani të sinjalit si në figurë ndalohe lëvizja prapa (indietro).	6	Saktë
56	Në prani të sinjalit në figurë lejohet parakalimi i mjeteve në rrugë me një korsi për sens lëvizje.	6	Gabim
57	Sinjali në figurë paralajmëron devijim të rrugës për shkak të punimeve në rrugë.	6	Gabim
58	Sinjali në figurë paralajmëron një pjerrësi të rrezikshme.	6	Gabim
59	Në prani të sinjalit në figurë lejohet të kryhet manovra e lëvizjes mbrapa.	6	Gabim
60	Në prani të sinjalit në figurë lejohet qëndrimi i mjetit edhe në kthesë.	6	Gabim
61	Sinjali në figurë, si rregull, në rrugë interurbane është 150 metër para fillimit të kthesave.	7	Saktë



62	Sinjali në figurë paralajmëron kthesa të rrezikshme dhe të njëpasnjëshme, prej të cilave kthesa e parë është majtas.	7	Saktë
63	Sinjali në figurë paralajmëron kthesa me dukshmëri të kufizuar.	7	Saktë
64	Në prani të sinjalit në figurë duhet zvogëluar shpejtësia e lëvizjes së mjetit duke e përshtatur atë me fushëpamjen.	7	Saktë
65	Në prani të sinjalit në figurë, në rrugë me dy sense lëvizje dhe me një korsi për sens, duhet të tregohet kujdes kur këmbehemi me një mjet tjetër.	7	Saktë
66	Sinjali në figurë paralajmëron dy kthesa për shkak të punimeve në rrugë.	7	Gabim
67	Sinjali në figurë paralajmëron dy kurrize rrugore.	7	Gabim
68	Sinjali në figurë paralajmëron një pjerrësi të rrezikshme.	7	Gabim
69	Sinjali në figurë tregon hyrje në një tunel.	7	Gabim
70	Sinjali në figurë lejon qëndrimin e mjetit në çdo pjesë të rrugës.	7	Gabim
71	Sinjali në figurë kërkon uljen e shpejtësisë vetëm para kthesës së parë.	7	Gabim
72	Sinjali në figurë është një sinjal vertikal që paralajmëron rrezik.	8	Saktë
73	Sinjali në figurë paralajmëron një kalim në nivel të ruajtur me barriera ose me gjysmëbarriera.	8	Saktë
74	Sinjali në figurë paralajmëron kalim në nivel pranë të cilit ka drita të kuqe dhe aparate akustikë.	8	Saktë
75	Në prani të sinjalit në figurë duhet zvogëluar shpejtësia e lëvizjes së mjetit.	8	Saktë
76	Sinjali në figurë paralajmëron ndërprerjen e rrugës me një linjë hekurudhore.	8	Saktë
77	Në prani të sinjalit në figurë ndalohet qëndrimi i mjetit në afërsi ose përgjatë kalimit në nivel.	8	Saktë
78	Sinjali në figurë paralajmëron një kalim në nivel, të paruaritur me barriera ose me gjysmëbarriera.	8	Gabim
79	Sinjali në figurë paralajmëron se jemi në afërsi të një stacioni treni me disa linja hekurudhore.	8	Gabim
80	Sinjali në figurë paralajmëron se rruga në vazhdim është e mbyllur.	8	Gabim
81	Sinjali në figurë paralajmëron një rrugë me një karrexhatë dhe me tri korsi lëvizjeje.	8	Gabim
82	Sinjali në figurë është sinjal vertikal rreziku.	9	Saktë



83	Sinjali në figurë paralajmëron ndërprerjen e rrugës me një linjë hekurudhore të pambrojtur.	9	Saktë
84	Në prani të sinjalit në figurë drejtuesit e mjeteve duhet të rrisin kujdesin në drejtimin e mjetit.	9	Saktë
85	Sinjali në figurë paralajmëron kalim në nivel të pa mbrojtur.	9	Saktë
86	Në prani të sinjalit në figurë ndaloheq qëndrimi i mjetit si në afërsi ashtu dhe përgjatë kalimit në nivel pa pengesa.	9	Saktë
87	Në prani të sinjalit në figurë duhet të sigurohemi si nga e djathta dhe nga e majta, para se të kapërcejmë linjën hekurudhore.	9	Saktë
88	Në prani të sinjalit në figurë duhet të tregojmë kujdes për të shmangur përplasjen me trenin.	9	Saktë
89	Sinjali në figurë paralajmëron kryqëzim të linjave hekurudhore me njëra-tjetrën.	9	Gabim
90	Sinjali në figurë paralajmëron një kalim në nivel, të pajisur me gjysmëbarriera.	9	Gabim
91	Sinjali në figurë paralajmëron një ndërprerje të rrugës me një linjë hekurudhore të mbrojtur me barriera.	9	Gabim
92	Sinjali në figurë na detyron të ndalojmë para vijës së ndalimit, kur është duke ardhur një tren.	10	Saktë
93	Sinjali në figurë vendoset në rrugë pas sinjalit të rrezikut "KALIM NË NIVEL PA BARRIERA" dhe pranë linjës hekurudhore që ndërpret rrugën.	10	Saktë
94	Sinjali në figurë paralajmëron kryqëzim linjash hekurudhore.	10	Gabim
95	Sinjali në figurë paralajmëron se po i afrohemi një kalimi në nivel me dy ose me shumë linja hekurudhore, i paruajtur.	11	Saktë
96	Në prani të sinjalit në figurë detyrohet ndalimi i mjetit para vijës së ndalimit, nëse ka lëvizje të trenave.	11	Saktë
97	Në prani të sinjalit në figurë duhet të tregojmë kujdes sepse mund të vijë treni si nga njëra linjë ashtu dhe nga tjetra.	11	Saktë
98	Sinjali në figurë shoqërohet me semafor me dy drita të kuqe.	11	Saktë
99	Sinjali në figurë lejon qëndrimin e mjetit.	11	Gabim
100	Sinjali në figurë paralajmëron kalim në nivel me një pale shina.	11	Gabim
101	Panelet distancometrike në figurë gjenden para një kalimi në nivel ose para një ure të lëvizshme.	13	Saktë
102	Paneli me 1 vijë të kuqe në figurë, tregon se në largësinë 50 metër ndodhet një kalim në nivel apo urë e lëvizshme.	13	Saktë
103	Paneli me 2 vija të kuqe në figurë, tregon se në largësinë 100 metër ndodhet një kalim në nivel apo urë e lëvizshme.	13	Saktë



104	Paneli me 3 vija të kuqe në figurë, tregon se në largësinë 150 metër ndodhet një kalim në nivel apo urë e lëvizshme.	908	Saktë
105	Sinjali si në figurë tregon se pas 150 metër ndodhet një kalim në nivel i pa mbrojtur.	909	Saktë
106	Paneli me 3 vija të kuqe në figurë, tregon se në largësinë 50 metër ndodhet një kalim në nivel apo urë e lëvizshme.	13	Gabim
107	Panelet distancometrike na detyrojmë të ndalojmë para tyre.	13	Gabim
108	Panelet distancometrike si në figurë gjenden vetëm në kalimet në nivel pa pengesa.	13	Gabim
109	Panelet distancometrike si në figurë tregojnë që rruga është e përmbytur.	13	Gabim
110	Paneli me 1 vijë të kuqe në figurë, tregon se në largësinë 150 metër ndodhet një kalim në nivel apo urë e lëvizshme.	13	Gabim
111	Sinjali në figurë paralajmëron një linjë tramvaji, të parregulluar me semafor.	14	Saktë
112	Sinjali në figurë paralajmëron një linjë tramvaji që ndërpret ose ngushton karrexhatën.	14	Saktë
113	Në prani të sinjalit në figurë duhet të tregojmë kujdes që të mos pengojmë kalimin e tramvajit.	14	Saktë
114	Sinjali në figurë paralajmëron një kalim në nivel pa barriera.	14	Gabim
115	Sinjali në figurë tregon se kemi përparësi ndaj tramvajit tramvajit.	14	Gabim
116	Sinjali në figurë është një sinjal vertikal që paralajmëron rrezik.	15	Saktë
117	Sinjali në figurë paralajmëron një vendkalim këmbësorësh të rregulluar me sinjale horizontale.	15	Saktë
118	Në prani të sinjalit në figurë duhet të tregoni kujdes për t'i dhënë përparësi këmbësorëve që kalojnë mbi vijat e bardha.	15	Saktë
119	Sinjali në figurë gjendet edhe në rrugë urbane.	15	Saktë
120	Në prani të sinjalit në figurë ndalohet qëndrimi mbi vijat e bardha pasi bllokojmë kalimin e këmbësorëve.	15	Saktë
121	Në prani të sinjalit në figurë ndalohet parakalimi i mjeteve që po ngadalësojnë shpejtësinë, për t'i dhënë përparësi këmbësorëve.	15	Saktë
122	Sinjali në figurë paralajmëron një vend që frekuentohet vetëm nga fëmijët.	15	Gabim
123	Sinjali në figurë ndalon kalimin e këmbësorëve.	15	Gabim
124	Sinjali në figurë na kujton përdorimin e borive për të tërhequr vëmendjen e këmbësorëve në rrugë.	15	Gabim



125	Sinjali në figurë kërkon t'u jepet përparësi vetëm fëmijëve që dalin nga shkolla.	15	Gabim
126	Sinjali në figurë paralajmëron një vendkalim biçikletash të rregulluar me sinjale horizontale.	16	Saktë
127	Në prani të sinjalit në figurë duhet zvogëluar shpejtësia e lëvizjes së mjetit dhe t'i japim përparësi biçiklistëve që kalojnë karrexhatën.	16	Saktë
128	Në prani të sinjalit në figurë duhet të zvogëlojmë shpejtësinë e lëvizjes së mjetit dhe po të jetë e nevojshme, të ndalojmë lëvizjen.	16	Saktë
129	Në prani të sinjalit në figurë ndalohet parakalimi i mjeteve që kanë ndaluar për t'i dhënë përparësi biçiklistëve.	16	Saktë
130	Sinjali në figurë vendoset pas çdo vendkalimi për biçikletat.	16	Gabim
131	Në prani të sinjalit në figurë nuk është e nevojshme të zvogëlohet shpejtësia e lëvizjes së mjetit.	16	Gabim
132	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e biçikletave.	16	Gabim
133	Sinjali në figurë vendoset për të treguar gara çiklistike në rrugë.	16	Gabim
134	Sinjali në figurë është një sinjal vertikal që paralajmëron rrezik.	17	Saktë
135	Sinjali në figurë, si rregull, në rrugë interurbane është 150 metër para pikës ku fillon zbritja e rrezikshme.	17	Saktë
136	Sinjali në figurë paralajmëron një zbritje të rrezikshme me pjerrësi 10%.	17	Saktë
137	Në prani të sinjalit në figurë duhet të kemi parasysh që gjatësia e frenimit të mjetit në zbritje rritet në krahasim me atë në rrugë të drejtë.	17	Saktë
138	Sinjali në figurë paralajmëron të jemi të kujdesshëm me shpejtësinë e lëvizjes.	17	Saktë
139	Pas sinjalit në figurë duhet të shmangim përdorimin e shpeshtë të frenave pasi mbinxehen elementët frenues.	17	Saktë
140	Në prani të sinjalit në figurë duhet të rrisim distancën me mjetet që kemi përpara.	17	Saktë
141	Në prani të sinjalit në figurë duhet të tregojmë kujdes, sidomos kur rruga është e lagur.	17	Saktë
142	Në prani të sinjalit në figurë mund ta shtojmë shpejtësinë.	17	Gabim
143	Sinjali në figurë paralajmëron se nuk lejohet të kalohet shpejtësia prej 10 km/orë.	17	Gabim
144	Sinjali në figurë kërkon të ecim me marshin më të lartë dhe ta ruajmë shpejtësinë me anën e frenimeve të vazhdueshme.	17	Gabim
145	Sinjali në figurë është një sinjal vertikal që paralajmëron rrezik.	18	Saktë



146	Sinjali në figurë paralajmëron një ngjitje të rrezikshme me pjerrësi prej 10%.	18	Saktë
147	Sinjali në figurë paralajmëron një rrugë me të përpjetë të fortë.	18	Saktë
148	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge që duhet përshkuar me friksionin e shkelur plotësisht.	18	Gabim
149	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge me kthesa të ngushta.	18	Gabim
150	Sinjali në figurë paralajmëron një rrugë në zbritje me pjerrësi 10%.	18	Gabim
151	Sinjali në figurë është një sinjal vertikal që paralajmëron rrezik.	19	Saktë
152	Sinjali në figurë paralajmëron ngushtim të karrexhatës nga të dy anët.	19	Saktë
153	Sinjali në figurë paralajmëron se shkëmbimi i mjeteve në atë vend është i vështirë.	19	Saktë
154	Në prani të sinjalit në figurë duhet zvogëluar shpejtësia e lëvizjes së mjetit.	19	Saktë
155	Në prani të sinjalit në figurë duhet të rrisim shpejtësia e lëvizjes së mjetit për ta kaluar sa me shpejt.	19	Gabim
156	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e autobusëve në atë segment rruge.	19	Gabim
157	Sinjali në figurë paralajmëron një hyrje në tunel për mjetet.	19	Gabim
158	Sinjali në figurë paralajmëron ngushtim të rrugës nga e majta.	20	Saktë
159	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge e cila duhet të përshkohet me kujdes.	20	Saktë
160	Sinjali në figurë paralajmëron një ngushtim rruge me gjatësi prej 380 metër.	903	Saktë
161	Në prani të sinjalit në figurë duhet të ulim shpejtësinë e lëvizjes së mjetit dhe nëse është e nevojshme të ndalojmë lëvizjen.	20	Saktë
162	Sinjali në figurë paralajmëron vështirësi në këmbimin e mjeteve në atë segment rruge.	20	Saktë
163	Sinjali në figurë tregon se këmbim i mjeteve mund të kryhet pa vështirësi në atë segment rruge.	20	Gabim
164	Sinjali në figurë paralajmëron se po i afrohem një rruge me gunga.	20	Gabim
165	Sinjali në figurë paralajmëron një mbikalim të rrugës.	20	Gabim
166	Sinjali në figurë paralajmëron një nënkalim për këmbësorët në atë vend.	20	Gabim



167	Sinjali në figurë paralajmëron ngushtim të karrexhatës nga krahu i djathtë.	20	Gabim
168	Sinjali në figurë është një sinjal vertikal që paralajmëron rrezik.	21	Saktë
169	Sinjali në figurë, si rregull, në rrugë interurbane është 150 metër para zonës ku fillon të ngushtohet rruga.	21	Saktë
170	Sinjali në figurë paralajmëron ngushtim të karrexhatës nga e djathta.	21	Saktë
171	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge e cila duhet të përshkohet me kujdes.	21	Saktë
172	Në prani të sinjalit në figurë duhet të zvogëlojmë shpejtësinë e lëvizjes së mjetit dhe nëse është e nevojshme, të ndalojmë lëvizjen.	21	Saktë
173	Sinjali në figurë paralajmëron vështirësinë e këmbimit të mjeteve në atë segment rruge.	21	Saktë
174	Sinjali në figurë paralajmëron se po afrohem në një pjesë rruge të deformuar.	21	Gabim
175	Sinjali në figurë paralajmëron një mbikalim të rrugës.	21	Gabim
176	Sinjali në figurë paralajmëron për një nënkallim për këmbësorët në atë segment rruge.	21	Gabim
177	Sinjali në figurë paralajmëron një ngushtim të karrexhatës nga krahu i majtë.	21	Gabim
178	Sinjali në figurë është një sinjal vertikal që paralajmëron rrezik.	22	Saktë
179	Sinjali në figurë paralajmëron një urë të lëvizshme.	22	Saktë
180	Sinjali si në figurë paralajmëron urë të lëvizshme që është në funksionim 24 orë në ditë.	904	Saktë
181	Në prani të sinjalit në figurë duhet të zvogëlojmë shpejtësinë e lëvizjes së mjetit për të qenë të gatshëm të ndalojmë në rast se dritat e kuqe janë në veprim.	22	Saktë
182	Sinjali në figurë kërkon të ngadalësoni shpejtësinë që të ndaloni në kohën e duhur kur ura është duke u ngritur.	22	Saktë
183	Sinjali si në figurë paralajmëron se pas 150 metër ndodhet një urë e lëvizshme.	905	Saktë
184	Sinjali në figurë paralajmëron një kalim në nivel të mbrojtur me barriera.	22	Gabim
185	Sinjali në figurë kërkon që t'i japim përparësi mjeteve që vijnë përballë nesh.	22	Gabim
186	Sinjali në figurë është një sinjal vertikal që paralajmëron rrezik.	23	Saktë
187	Sinjali në figurë, si rregull, në rrugë interurbane është 150 metër para zonës ku fillon dëmtimi i bankinës.	23	Saktë



188	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge me bankinë të dëmtuar që mund të shembet.	23	Saktë
189	Në prani të sinjalit në figurë duhet të zvogëloni shpejtësinë e lëvizjes së mjetit dhe të mos zhvendoseni në bankinë.	23	Saktë
190	Sinjali si në figurë tregon se gjatësia e bankinës së dëmtuar është 2.8 km.	906	Saktë
191	Sinjali në figurë te detyron të lëvizim sa më djathtas karrexhatës.	23	Gabim
192	Sinjali në figurë tregon se ndalohej vazhdimi i lëvizjes në atë rrugë.	23	Gabim
193	Sinjali në figurë na detyron të rrisim shpejtësinë e lëvizjes.	23	Gabim
194	Sinjali në figurë paralajmëron një rrugë vetëm për kamionët ndërsa autoveturat ndalohej të kalojnë.	23	Gabim
195	Sinjali në figurë paralajmëron se rruga bëhet e rrëshqitshme nga shiu apo nga prezenca e akullit.	24	Saktë
196	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge ku fërkimi i gomave me rrugën zvogëlohet në raste shiu apo akulli.	24	Saktë
197	Në prani të sinjalit në figurë, nëse ka lagështi apo akull në rrugë, duhet të ulim shpejtësinë dhe të shmangim frenimet e forta.	24	Saktë
198	Pas sinjalit në figurë, në kushte të vështira atmosferike, duhet rritur distanca e sigurisë me mjetin para.	24	Saktë
199	Sinjali në figurë paralajmëron rrugë të rrëshqitshme për arsye të prezencës së akullit.	907	Saktë
200	Sinjali në figurë paralajmëron një ngushtim të rrugës në atë segment rruge.	24	Gabim
201	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge ku rritet fërkimi i gomave të mjetit me rrugën.	24	Gabim
202	Sinjali në figurë paralajmëron se duhet të zvogëlojmë distancën e sigurisë me mjetet përpara.	24	Gabim
203	Sinjali në figurë paralajmëron një karrexhate të dëmtuar në shtresën e asfaltit.	24	Gabim
204	Sinjali në figurë paralajmëron se gjatësia e frenimit në këtë pjesë rruge zvogëlohet.	24	Gabim
205	Sinjali në figurë paralajmëron rrezik.	25	Saktë
206	Sinjali në figurë paralajmëron vende që frekuentohen nga fëmije si, shkolla, kopshte, parqe publike etj..	25	Saktë
207	Sinjali në figurë paralajmëron se duhet të bëjmë shumë kujdes, për arsye se në rrugë mund të kalojnë fëmijë.	25	Saktë
208	Në prani të sinjalit në figurë duhet të ulim shpejtësinë dhe të lëvizim me kujdes, edhe nëse fëmijët janë në trotuar.	25	Saktë



209	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e fëmijëve të pashoqëruar me të rritur.	25	Gabim
210	Sinjali në figurë lajmëron fëmijët që të mos zbresin nga trotuari.	25	Gabim
211	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e mjeteve në oraret që dalin fëmijët nga shkolla.	25	Gabim
212	Në prani të sinjalit në figurë duhet të tregojmë kujdes për shkak të pranisë së mundshme të kafshëve shtëpiake në karrexhatë.	26	Saktë
213	Sinjali në figurë paralajmëron praninë e mundshme të mjeteve të tërhequra nga kafshët.	26	Gabim
214	Sinjali në figurë na detyron të ulim shpejtësinë dhe t'i biem borisë për të larguar kafshët nga rruga.	26	Gabim
215	Sinjali në figurë është një sinjal vertikal që paralajmëron rrezik.	27	Saktë
216	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë të rrugës ku mund të kalojnë papritur kafshë të egra.	27	Saktë
217	Në prani të sinjalit në figurë duhet të ulim shpejtësinë e lëvizjes së mjetit dhe të ndalojmë, nëse kafshët japin shenja paniku.	27	Saktë
218	Sinjali në figurë paralajmëron një zonë pyjore në të cilën është i ndaluar kampingu.	27	Gabim
219	Sinjali në figurë na detyron të rrisim shpejtësinë e lëvizjes.	27	Gabim
220	Sinjali në figurë paralajmëron një rrezik.	28	Saktë
221	Sinjali në figurë paralajmëron se karrexhata do të bëhet me dy sense lëvizjeje, nga një sens lëvizjeje që ishte më parë.	28	Saktë
222	Sinjali në figurë paralajmëron se mbaron rruga ku qarkullimi është me një sens lëvizjeje.	28	Saktë
223	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rrugë me qarkullim në dy sense.	28	Saktë
224	Sinjali në figurë paralajmëron se qarkullimi do të bëhet me një sens lëvizjeje.	28	Gabim
225	Sinjali në figurë, si rregull, në rrugë interurbane është i vendosur 150 metër përpara rrethrotullimit.	29	Saktë
226	Sinjali në figurë paralajmëron një kryqëzim të rregulluar me rrethrotullim.	29	Saktë
227	Sinjali në figurë paralajmëron se në rrethrotullimin që vjen, ndalohet kthimi djathtas.	29	Gabim
228	Sinjali në figurë paralajmëron një rrugë të mbyllur dhe jemi të detyruar të kthehemi mbrapsht.	29	Gabim
229	Sinjali në figurë është një sinjal vertikal që paralajmëron rrezik.	30	Saktë



230	Sinjali në figurë paralajmëron se rruga përfundon në një mol ose dige me rrezikun e rënies në ujë.	30	Saktë
231	Në prani të sinjalit në figurë drejtuesit e mjeteve duhet të tregojnë kujdes, sidomos natën, pasi rrezikojnë rënien në ujë.	30	Saktë
232	Sinjali në figurë paralajmëron një urë të lëvizshme.	30	Gabim
233	Sinjali në figurë paralajmëron një urë të prishur.	30	Gabim
234	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge në formë të lugët.	30	Gabim
235	Sinjali në figurë është një sinjal vertikal që paralajmëron rrezik.	31	Saktë
236	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge ku mund të ketë materiale të paqëndrueshme si: çakëll, zhavorr, rërë etj..	31	Saktë
237	Në prani të sinjalit në figurë duhet të tregojmë kujdes nëse ka këmbësorë anash rrugës.	31	Saktë
238	Në prani të sinjalit në figurë duhet të zvogëlojmë shpejtësinë e lëvizjes së mjetit, sidomos kur shkëmbehemi me mjete të tjera.	31	Saktë
239	Në prani të sinjalit në figurë duhet të mbajmë distancë më të madhe se zakonisht me mjetet përpara.	31	Saktë
240	Në prani të sinjalit në figurë duhet të ulim shpejtësinë sepse mund të zvogëlohet kontakti i gomave me rrugën.	31	Saktë
241	Nëse sinjali si në figurë është me fushë të verdhë, paralajmërohen materiale të paqëndrueshme në rrugë për shkak punimesh.	31	Saktë
242	Sinjali në figurë këshillon ta shtojmë shpejtësinë, me qëllim që të rrisim fërkimin e gomave me rrugën.	31	Gabim
243	Sinjali në figurë paralajmëron një rrugë me bankinë të dëmtuar.	31	Gabim
244	Sinjali në figurë paralajmëron një rrugë ku shfaqet rreziku i rënies së gurëve nga e djathta.	31	Gabim
245	Sinjali në figurë paralajmëron një rrezik.	32	Saktë
246	Sinjali në figurë paralajmëron rrezikun e rënies së gurëve nga një shkëmb në anën e majtë të rrugës.	32	Saktë
247	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge në të cilën mund të ketë gurë ose masa dheu të shkëputura nga shkëmbi në të majtë.	32	Saktë
248	Në prani të sinjalit në figurë duhet të zvogëlojmë shpejtësinë e lëvizjes së mjetit për të shmangur përplasjen me gurët e mundshëm në rrugë.	32	Saktë
249	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë të rrugës ku bëhen punime.	32	Gabim
250	Sinjali në figurë paralajmëron se për të shmangur rrezikun, duhet t'i biem borive fort.	32	Gabim



251	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge me shtresë rrugore të rregullt.	32	Gabim
252	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge të deformuar.	32	Gabim
253	Sinjali në figurë është një sinjal vertikal që paralajmëron rrezik.	33	Saktë
254	motor	33	Saktë
255	Sinjali në figurë paralajmëron rrezikun e rënies së gurëve nga një shkëmb në anën e djathtë të rrugës.	33	Saktë
256	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge në të cilën mund të ketë gurë ose masa dheu të shkëputur nga shkëmbi në të djathtë.	33	Saktë
257	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge ku bëhen punime rrugore.	33	Gabim
258	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge të paasfaltuar.	33	Gabim
259	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge të deformuar.	33	Gabim
260	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge me bankinë të dëmtuar që mund të shembet.	33	Gabim
261	Sinjali në figurë paralajmëron një impiant semaforik, me vendosje vertikale të fenerëve.	34	Saktë
262	Në prani të sinjalit në figurë duhet të zvogëlojmë shpejtësinë e lëvizjes së mjetit, për të qenë të gatshëm të ndalojmë kur është ndezur drita e kuqe e semaforit.	34	Saktë
263	Sinjali në figurë kur është me fushë të verdhë paralajmëron një impiant semaforik të përkohshëm në rrugë.	34	Saktë
264	Sinjali në figurë paralajmëron një ndërprerje të rrugës me hekurudhën, me barriera.	34	Gabim
265	Sinjali në figurë paralajmëron praninë e një ure të lëvizshme.	34	Gabim
266	Sinjali në figurë paralajmëron rrugë me një sens.	34	Gabim
267	Sinjali në figurë është sinjal vertikal rreziku.	35	Saktë
268	Sinjali në figurë paralajmëron një impiant semaforik, me vendosje horizontale të fenerëve.	35	Saktë
269	Në prani të sinjalit në figurë duhet të zvogëlojmë shpejtësinë e lëvizjes së mjetit për të qenë të gatshëm të ndalojmë kur është ndezur drita e kuqe e semaforit.	35	Saktë
270	Sinjali në figurë paralajmëron një ndërprerje të rrugës me hekurudhën e mbrojtur me barriera.	35	Gabim



271	Sinjali në figurë paralajmëron praninë e një ure të lëvizshme.	35	Gabim
272	Sinjali në figurë paralajmëron një rrezik.	36	Saktë
273	Sinjali në figurë paralajmëron zhurmë ose dritë të fortë nga ulja apo ngritja e avionëve.	36	Saktë
274	Sinjali në figurë paralajmëron mundësinë e zhurmave ose verbimit nga drita e fortë që shkaktohet nga fluturimi i avionëve në lartësi të vogël.	36	Saktë
275	Në prani të sinjalit në figurë duhet të bëni kujdes për shkak të shqetësimit që mund të sjellin fluturimet e avionëve në kuota të ulëta.	36	Saktë
276	Sinjali në figurë ndalon hyrjen në aeroporte.	36	Gabim
277	Sinjali në figurë paralajmëron kryqëzime rrugësh të rrezikshme.	36	Gabim
278	Sinjali në figurë paralajmëron një zonë ku fluturojnë avionëve në lartësi të madhe.	36	Gabim
279	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge, në të cilën krijohen erëra të forta anësore.	37	Saktë
280	Sinjali në figurë paralajmëron mundësinë e erërave të forta anësore kur del nga një tunel.	37	Saktë
281	Sinjali në figurë paralajmëron rrezikun nga era e fortë, sidomos për mjetet me karroceri të mbyllur me tenda ose rimorkiot.	37	Saktë
282	Sinjali në figurë paralajmëron një pjesë rruge afër një aeroporti.	37	Gabim
283	Sinjali në figurë paralajmëron drejtimin e erës për ngritjen dhe uljen e avionëve.	37	Gabim
284	Në prani të sinjalit në figurë duhet të rrisim shpejtësinë, sidomos në daljet nga tunelet kur era është e fortë.	37	Gabim
285	Sinjali në figurë është sinjal vertikal rreziku.	38	Saktë
286	Sinjali në figurë paralajmëron një zonë anash rrugës, me barë, gjethe ose shkurre, ku rrezikohet ndezja nga zjarri.	38	Saktë
287	Në prani të sinjalit në figurë nuk duhet të hidhen cigare ose shkrepsë të ndezura.	38	Saktë
288	Sinjali në figurë paralajmëron rrezikun e një shpërthimi.	38	Gabim
289	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e mjeteve që transportojnë produkte që marrin flakë shpejt.	38	Gabim
290	Sinjali në figurë paralajmëron mundësinë e një ere të fortë anësore.	38	Gabim
291	Sinjali në figurë është një sinjal vertikal që paralajmëron rrezik.	39	Saktë



292	Sinjali në figurë paralajmëron një rrezik të ndryshëm nga ata që janë parashikuar në sinjalet e tjerë të rrezikut.	39	Saktë
293	Sinjali në figurë paralajmëron një ngjitje (të përpjetë) të vështirë.	39	Gabim
294	Sinjali në figurë është sinjal vertikal ndalimi.	54	Saktë
295	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e mjeteve në të dy senset.	54	Saktë
296	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e të gjithë mjeteve rrugore.	54	Saktë
297	Në prani të sinjalit në figurë lejohet qarkullimi i këmbësorëve.	54	Saktë
298	Sinjali në figurë me panelin plotësues vendosur poshtë tij tregon se ndalim qarkullimi i mjeteve është në fuqi nga ora 7 e 30 minuta deri në orën 19:00.	910	Saktë
299	Sinjali në figurë është ndalim qarkullimi vetëm për mjetet me motor.	54	Gabim
300	Sinjali në figurë paralajmëron një rrugë me një sens lëvizjeje.	54	Gabim
301	Sinjali në figurë lejon qarkullimin e ciklomotorëve.	54	Gabim
302	Sinjali në figurë ndalon hyrjen për të gjitha mjetet që kanë përballë këtë sinjal.	55	Saktë
303	Sinjali në figurë është ndalim kalimi edhe për taksitë.	55	Saktë
304	Sinjali në figurë është ndalim kalimi edhe për mjetet pa motor.	55	Saktë
305	Sinjali në figurë është i vlefshëm edhe në orët e natës.	55	Saktë
306	Sinjali në figurë ndalon kalimin dhe për biçikletat dhe për ciklomotorët.	55	Saktë
307	Sinjali në figurë lejon hyrjen në rrugë të ciklomotorëve.	55	Gabim
308	Sinjali në figurë lejon hyrjen në rrugë të motokarrove.	55	Gabim
309	Sinjali në figurë tregon ndalim parakalimi.	55	Gabim
310	Sinjali në figurë tregon se ndalohet qëndrimi dhe pushimi për mjetet.	55	Gabim
311	Sinjali në figurë është një sinjal vertikal ndalimi.	56	Saktë
312	Në prani të sinjalit në figurë lejohet të parakalohen biçikletat ose mjete të tjera pa motor, me kusht që manovra të bëhet brenda korsisë së lëvizjes.	56	Saktë



313	Në prani të sinjalit në figurë lejohet që një autoveturë të parakalojë një motor me dy rrota, me kusht që manovra të bëhet brenda korsisë së lëvizjes.	56	Saktë
314	Sinjali në figurë lejon një motor ose ciklomotor të parakalojë një motor ose ciklomotor tjetër.	56	Saktë
315	Në prani të sinjalit në figurë ndalohet që një motor ose ciklomotor të parakalojë një autoveturë.	56	Saktë
316	Sinjali në figurë lejon një motor të parakalojë një autoveturë.	56	Gabim
317	Sinjali në figurë e lejon manovrën e parakalimit të një autoveturë por pa e kapërcyer vijën gjatësore të pandërprerë.	56	Gabim
318	Sinjali në figurë ndalon një autoveturë të parakalojë një ciklomotor.	56	Gabim
319	Sinjali në figurë është një sinjal vertikal ndalimi.	57	Saktë
320	Sinjali në figurë ndalon të ndjekësh mjetin që ke përpara në distancë më të vogël se ajo që tregon sinjali.	57	Saktë
321	Sinjali në figurë është i vlefshëm edhe për motomjetet.	57	Saktë
322	Sinjali në figurë ndalon mjetin ti afrohet mjetit që ka përpara në distancë më të vogël se 70 metër.	57	Saktë
323	Sinjali në figurë paraqet kufizim shpejtësie prej 70 km/orë për autoveturat.	57	Gabim
324	Sinjali në figurë tregon se pas një distance 70 metër fillon ndalim qarkullimi për autoveturat.	57	Gabim
325	Sinjali në figurë ndalon të tejkalohet shpejtësia 80 km/orë.	58	Saktë
326	Sinjali në figurë mund të gjendet edhe në autostrada.	58	Saktë
327	Vlefshmëria e sinjalit në figurë fillon menjëherë pas tij.	58	Saktë
328	Në prani të sinjalit në figurë jemi të detyruar të lëvizim me shpejtësi më të vogël ose të barabartë me 80 km/orë.	58	Saktë
329	Sinjali në figurë detyron të ruash një distancë sigurie me mjetin përpara të paktën 80 metër.	58	Gabim
330	Sinjali në figurë tregon një kufi të shpejtësisë të vlefshëm vetëm për autoveturat.	58	Gabim
331	Sinjali në figurë të detyron të mbash një distancë sigurie me mjetin përpara të paktën 80 metër.	58	Gabim
332	Sinjali në figurë tregon që në çdo rast duhet të qarkullojmë me shpejtësi 80 km/orë.	58	Gabim
333	Sinjali në figurë tregon fillimin e një zone ku është e ndaluar të përdorësh sinjalizimin zanor të mjetit (borinë).	59	Saktë



334	Në prani të sinjalit në figurë ndalohet të përdorësh borinë.	59	Saktë
335	Në prani të sinjalit në figurë lejohet përdorimi i borive, por vetëm në raste rreziku të papritur.	59	Saktë
336	Sinjali në figurë mund të mos respektohet në rastin kur po transportojmë të aksidentuar ose të sëmurë rendë.	59	Saktë
337	Sinjali në figurë duhet të respektohet vetëm natën.	59	Gabim
338	Sinjali në figurë lejon përdorimin e borive, kur mjete përpara po vonohet në semafor me dritën jeshile të ndezur.	59	Gabim
339	Sinjali në figurë lejon një kamion me ngarkesë të plotë mbi 3.5 tonë të parakalojë një mjet me motor me dy rrota, brenda korsisë së lëvizjes.	60	Saktë
340	Sinjali në figurë lejon një autoveturë të parakalojë një mjet transporti mallrash.	60	Saktë
341	Sinjali në figurë ndalon parakalimin për mjete me peshë me ngarkesë të plotë 3 tonë.	60	Gabim
342	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e të gjithë llojeve të mjeteve pa motor.	61	Gabim
343	Sinjali në figurë lejon qarkullimin e mjeteve me motor.	62	Saktë
344	Sinjali në figurë lejon qarkullimin e biçiklistëve.	62	Saktë
345	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e ciklomotorëve.	62	Gabim
346	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e biçikletave.	63	Saktë
347	Sinjali në figurë lejon qarkullimin e motomjeteve.	63	Saktë
348	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin edhe të ciklomotorëve.	63	Gabim
349	Sinjali në figurë tregon një korsi të rezervuar për biçikletat dhe ciklomotorët.	63	Gabim
350	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e motorëve.	64	Saktë
351	Sinjali në figurë lejon qarkullimin e motorëve.	64	Gabim
352	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e të gjithë mjeteve me dy rrota.	64	Gabim
353	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin për të gjithë ciklomotorët.	64	Gabim
354	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin për mjetet me motor, përjashtuar ato me dy rrota.	66	Saktë



355	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin për të gjitha automjetet dhe motomjetet me tre rrota.	66	Saktë
356	Në prani të sinjalit në figurë lejohet qarkullimi i mjeteve me dy rrota.	66	Saktë
357	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e motokarrove.	66	Saktë
358	Në prani të sinjalit në figurë lejohet qarkullimi i mjeteve pa motor.	66	Saktë
359	Sinjali në figurë lejon qarkullimin e motorëve me tri rrota (motorë me kosh).	66	Gabim
360	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin vetëm të autoveturave.	66	Gabim
361	Sinjali në figurë lejon qarkullimin e taksive.	66	Gabim
362	Sinjali në figurë lejon qarkullimin e motomjeteve me tri rrota.	66	Gabim
363	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin për autobusët.	67	Saktë
364	Sinjali në figurë lejon qarkullimin e gjithë mjeteve të tjera me përjashtim të Autobusëve.	67	Saktë
365	Sinjali në figurë lejon qarkullimin e autobusëve të shkollave.	67	Gabim
366	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e automjeteve për transport malli me peshë me ngarkesë të plotë mbi 3.5 tonë.	68	Saktë
367	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e një automjeti për transport malli me peshë me ngarkesë të plotë deri në 3.5 tonë.	68	Gabim
368	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e autoambulancave.	69	Gabim
369	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e mjeteve që tërheqin një rimorkio.	70	Saktë
370	Sinjali në figurë tregon që kamionët duhet të ruajnë një distancë sigurie 100 metër mes njëri-tjetrit.	70	Gabim
371	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e makinave bujqësorë.	71	Saktë
372	Sinjali në figurë lejon qarkullimin e motomjeteve.	71	Saktë
373	Sinjali në figurë lejon qarkullimin e makinave bujqësore.	71	Gabim
374	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e autokarrove.	71	Gabim
375	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e mjeteve që transportojnë mallra të rrezikshme.	72	Saktë



376	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e automjeteve që përdorin si karburant djegës gaz të lëngët.	72	Gabim
377	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e mjeteve që transportojnë lëndë plasëse ose që ndizen lehtë.	73	Saktë
378	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e autoveturave që përdorin si karburant naftën.	73	Gabim
379	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e mjeteve që transportojnë lëndë që mund të ndotin ujin.	74	Saktë
380	Sinjali në figurë urdhëron ndalim qarkullimi për mjete që janë më të gjerë se 2.3 metër.	75	Saktë
381	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e të gjitha mjeteve që kanë gjerësi më të madhe se ajo e treguar në të.	75	Saktë
382	Sinjali në figurë tregon gjerësinë maksimale të mjeteve që mund të kalojnë.	75	Saktë
383	Sinjali në figurë tregon distancën minimale të sigurisë që mjetet duhet të respektojnë në këtë rrugë.	75	Gabim
384	Sinjali në figurë tregon ndalim qarkullimi për mjete që janë më të larta se 3.5 metër.	76	Saktë
385	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e mjeteve që tejkalojnë lartësinë 3.5 metër.	76	Saktë
386	Në prani të sinjalit në figurë lejohet qarkullimi i mjeteve me lartësi deri në 3.5 metër.	76	Saktë
387	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e një mjete me lartësi deri në 3.5 metër.	76	Gabim
388	Sinjali në figurë tregon ndalim qarkullimi për mjete me gjatësi mbi 10 metër.	77	Saktë
389	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e mjeteve me gjatësi mbi 10 metër.	77	Saktë
390	Sinjali në figurë lejon qarkullimin e mjeteve me gjatësi deri në 10 metër.	77	Saktë
391	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e një mjete me lartësi deri në 3.5 metër.	77	Gabim
392	Sinjali në figurë lejon qarkullimin e autoveturave që tërheqin një rimorkio edhe kur kalohet gjatësia 10 metër.	77	Gabim
393	Sinjali në figurë ndalim qarkullimin e mjeteve me peshe faktike mbi 7 tonë.	78	Saktë
394	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e mjeteve me gjatësi më të madhe se 7 metër (pa përjashtim).	78	Gabim
395	Sinjali në figurë ndalon kalimin e mjeteve që kanë në aksin më të ngarkuar një masë më të madhe se 6.5 tonë.	79	Saktë
396	Sinjali në figurë ndalon kalimin e mjeteve që kanë në aksin më të ngarkuar një masë më të vogël se 6.5 tonë.	79	Gabim



397	Sinjali në figurë tregon fundin e ndalimeve të mëparshme.	80	Saktë
398	Sinjali në figurë tregon se pas tij, sinjalet e ndalimit të mëparshme nuk kanë me vlerë.	80	Saktë
399	Sinjali në figurë tregon fundin e një pjese rruge të dëmtuar.	80	Gabim
400	Sinjali në figurë tregon fundin e kufizimit të shpejtësisë prej 50 km/orë të vendosur më parë.	81	Saktë
401	Sinjali në figurë lejon të qarkullohet me shpejtësi më të madhe se 50 km/orë por jo më shumë se shpejtësia e lejuar për atë rrugë.	81	Saktë
402	Sinjali në figurë të lejon të lëvizet edhe me shpejtësi më të vogël se 50 km/orë.	81	Saktë
403	Sinjali në figurë tregon kufirin e shpejtësisë së lejuar për të gjithë mjetet.	81	Gabim
404	Sinjali në figurë ndalon qarkullimin e mjeteve që kalojnë shpejtësinë 50 km/orë.	81	Gabim
405	Sinjali në figurë tregon fundin e ndalimit të parakalimit që ishte në fuqi më parë.	82	Saktë
406	Pas sinjalit në figurë lejohet parakalimi i automjeteve.	82	Saktë
407	Sinjali në figurë tregon fundin e ndalim qarkullimit për të gjithë automjetet.	82	Gabim
408	Sinjali në figurë tregon fundin e ndalimit të qëndrimit.	82	Gabim
409	Sinjali në figurë tregon ndalim qëndrimi në të dyja anët e rrugës.	82	Gabim
410	Sinjali në figurë lejon një kamion me rimorkio të parakalojë një autoveturë.	83	Saktë
411	Sinjali në figurë tregon fundin e ndalimit të parakalimit që ishte në fuqi më parë.	83	Saktë
412	Sinjali në figurë tregon fundin e "Ndalim parakalimi" të autoveturave.	83	Gabim
413	Sinjali në figurë tregon fundin e "Ndalim parakalimi" të motomjeteve.	83	Gabim
414	Sinjali në figurë ndalon pushimin e mjeteve ne krahun e rrugës ku është vendosur.	84	Saktë
415	Sinjali në figurë tregon vendin pas të cilit pushimi i mjetit është i ndaluar.	84	Saktë
416	Sinjali në figurë e lejon qëndrimin e mjetit.	84	Saktë
417	Sinjali në figurë i vendosur në rrugë urbane ndalon pushimin nga ora 8:00 deri në orën 20:00.	84	Saktë



418	Sinjali në figurë i vendosur në rrugë interurbane ndalon pushimin gjatë gjithë 24 orëve.	84	Saktë
419	Sinjali në figurë nëse nuk përsëritet, e humb vlefshmërinë pas kryqëzimit.	84	Saktë
420	Sinjali në figurë ndalon qëndrimin e mjetit.	84	Gabim
421	Sinjali në figurë lejon pushimin për motomjetet.	84	Gabim
422	Sinjali në figurë lejon pushimin e mjeteve për banorët e lagjes.	84	Gabim
423	Sinjali në figurë lejon pushimin e mjetit pas sinjalit.	84	Gabim
424	Sinjali në figurë ndalon qëndrimin e mjeteve.	85	Saktë
425	Sinjali në figurë është i vlefshëm për të gjithë mjetet.	85	Saktë
426	Sinjali në figurë ndalon pushimin dhe qëndrimin e mjeteve.	85	Saktë
427	Sinjali në figurë ndalon qëndrimin e mjeteve në krahun që është vendosur ai.	85	Saktë
428	Sinjali në figurë ndalon ndërprerjen e lëvizjes së mjetit për të marrë ose për të zbritur pasagjerë.	85	Saktë
429	Sinjali në figurë lejon qëndrimin edhe të taksive për të marrë pasagjerë apo bagazhe.	85	Gabim
430	Sinjali në figurë lejon pushimin e mjeteve me motor me dy rrota.	85	Gabim
431	Sinjali në figurë lejon qëndrimin e mjeteve sa për të hipur ose zbritur njerëzit nga mjete.	85	Gabim
432	Sinjali në figurë ka fuqi detyrimi edhe në anën tjetër të rrugës.	85	Gabim
433	Sinjali në figurë lejon edhe qëndrimin, edhe pushimin e mjeteve në të dy anët e rrugës.	85	Gabim
434	Sinjali në figurë tregon një ven parkimi për mjetet.	85	Gabim
435	Sinjali në figurë ndalon pushimin e mjeteve në zonën ku është vendosur.	90	Saktë
436	Sinjali në figurë tregon një zonë për hyrje-daljen e mjeteve ku është i ndaluar pushimi.	90	Saktë
3021	Paneli plotësues në figurë tregon se mund të gjendemi në trafik me lëvizje të ngadaltë të mjeteve.	136	Saktë
3022	Në prani të panelit plotësues në figurë duhet të keni kujdes për të shmangur rrezikun e përplasjes me mjetet e ndaluara për shkak të trafikut.	136	Saktë
3023	Paneli plotësues në figurë i vendosur në autostradë këshillon daljen nga autostrada për të shmangur ngadalësimet e mundshme.	136	Saktë



3024	Paneli plotësues në figurë këshillon të zgjedhim rrugë tjetër nëse është e mundur, për të shmangur trafikun.	136	Saktë
3025	Paneli plotësues në figurë, i vendosur në rrugët interurbane, këshillon lëvizjen në dy rreshta paralele në rast trafiku të dendur.	136	Gabim
3026	Paneli plotësues në figurë tregon një pjesë rruge të rezervuar vetëm për lëvizjen e autovecurave.	136	Gabim
3027	Paneli plotësues në figurë tregon praninë e mundshme të mjeteve të punës në rrugë.	137	Saktë
3028	Në prani të panelit në figurë duhet të rrisim kujdesin në drejtimin e mjetit.	137	Saktë
3029	Paneli plotësues në figurë tregon se ndaloheq qarkullimi i mjeteve me zinxhirë.	137	Gabim
3030	Paneli plotësues në figurë sinjalizon praninë e mjeteve të pastrimit publik që transportojnë plehra.	137	Gabim
3031	Paneli plotësues në figurë tregon praninë e një makine në veprim për pastrimin e borës.	137	Gabim
3032	Në prani të panelit plotësues në figurë, duhet të ulim shpejtësinë sepse rruga mund të jetë e rrëshqitshme.	138	Saktë
3033	Paneli plotësues në figurë tregon mundësinë e formimit të akullit në sipërfaqen e rrugës, si rezultat i uljes së temperaturave.	138	Saktë
3034	Paneli plotësues në figurë tregon mundësinë e krijimit të akullit mbi xhamin e përparmë.	138	Gabim
3035	Paneli plotësues në figurë tregon një pjesë rruge të rrezikshme nga prania e guralecëve.	138	Gabim
3036	Paneli plotësues në figurë tregon një pjesë rruge me sipërfaqe të rrezikshme kur bie shi.	139	Saktë
3037	Në prani të panelit plotësues në figurë, në rast shiu, distanca me mjetin përpara duhet të jetë me e madhe se zakonisht.	139	Saktë
3038	Në prani të panelit plotësues në figurë, në raste shiu, duhet të rregulloni shpejtësinë e lëvizjes së mjetit sepse sipërfaqja e rrugës bëhet e rrëshqitshme.	139	Saktë
3039	Paneli plotësues në figurë tregon një pjesë rruge të rrezikshme për shkak të pranisë së erërave anësore.	139	Gabim
3040	Paneli plotësues në figurë tregon një pjesë të rrugës ku krijohen pluhura dhe tymra.	139	Gabim
3041	Paneli plotësues në figurë tregon një zonë që shërben për matjet meteorologjike.	139	Gabim
3042	Paneli plotësues në figurë tregon një pjesë të rrugës në të cilën mund të gjenden kamionë që lëvizin ngadalë.	140	Saktë
3043	Në prani të panelit plotësues në figurë duhet kujdes sepse mund të ndeshim kamionë që lëvizin ngadalë në ngjitje.	140	Saktë
3044	Paneli plotësues në figurë tregon një pjesë të rrugës ku mund të gjenden mjete të rënda në lëvizje të ngadaltë.	140	Saktë



3045	Në prani të panelit plotësues në figurë duhet të tregoni kujdes sepse në korsinë që jeni duke lëvizur, gjenden mjete të aksidentuara.	140	Gabim
3046	Paneli plotësues në figurë tregon një pjesë rruge, në të cilën ndalohej tërheqja e mjeteve.	140	Gabim
3047	Paneli plotësues në figurë tregon bllokim rruge për shkak të një përplasje aksidentale në rrugë.	140	Gabim
3048	Paneli plotësues në figurë tregon një zonë ku mjetet e parkuara në atë vend mund të largohen në mënyrë të detyruar ose mund të bllokohen me pajisje të veçanta nga policia rrugore.	141	Saktë
3049	Paneli plotësues në figurë tregon një zonë ku pushimi i mjetit përbën një pengesë të madhe për qarkullimin.	141	Saktë
3050	Paneli plotësues në figurë tregon që mjeti i lënë në atë vend zhvendoset ose bllokohet nga punonjësit e policisë .	141	Saktë
3051	Paneli plotësues në figurë tregon se në rast defekti, mjeti duhet të lëvizet menjëherë me rimorkim.	141	Gabim
3052	Paneli plotësues në figurë tregon se qëndrimi është i rezervuar për makinat e ndihmës së shpejtë.	141	Gabim
3053	Paneli plotësues në figurë tregon rrezik për shkak të mjeteve me defekt që po tërhiqen.	141	Gabim
3054	Paneli plotësues në figurë tregon korsinë që duhet të ndiqet për një drejtim të caktuar.	142	Saktë
3055	Paneli plotësues në figurë tregon vendin ku rruga bëhet me një sens lëvizjeje.	142	Gabim
3056	Paneli plotësues A në figurë tregon afrimin e një kthese të fortë.	143	Saktë
3057	Paneli plotësues B në figurë tregon një pjesë rruge me tre kthesa të njëpasnjëshme.	143	Saktë
3058	Paneli plotësues B në figurë tregon numrin maksimal të mjeteve që mund të kalojnë në kthesë.	143	Gabim
3059	Paneli plotësues në figurë tregon kthesën e parë të një pjesë rruge me disa kthesa të rrezikshme .	144	Saktë
3060	Paneli plotësues në figurë tregon kthesën e parë të disa kthesave të forta.	144	Saktë
3061	Paneli plotësues në figurë tregon afrimin në një zonë me qarkullim rrotullues.	144	Gabim
3062	Paneli plotësues në figurë tregon distancën në kilometër nga ku ndodhet kthesa tjetër.	144	Gabim
3063	Paneli plotësues në figurë tregon që duhet të kthehemi mbrapa.	144	Gabim
3064	Paneli plotësues në figurë, i vendosur poshtë sinjalit “Ndalim Pushimi” tregon se nga e Hëna në të Premte, nga ora 21:00 deri në orën 4:00 ndalohej pushimi i mjeteve sepse bëhet pastrimi i rrugës.	145	Saktë



3065	Paneli plotësues në figurë tregon se duhet t'u jepet përparësi mjeteve të pastrimit publik.	145	Gabim
3066	Paneli plotësues në figurë tregon që në ditët dhe në orët e caktuara është i ndaluar pushimi për makinat pastruese.	145	Gabim
3067	Panelet plotësuese në figurë tregojnë vazhdimin e rrugëve kryesore dhe ndërprerjen e tyre me rrugë dytësore.	146	Saktë
3068	Panelet plotësuese B në figurë tregojnë se jemi në rrugë kryesore që në kthesë ndërpritet me 2 rrugë dytësore.	146	Saktë
3069	Panelet plotësuese në figurë tregojnë nënkalime në rrugët kryesore.	146	Gabim
3070	Panelet plotësuese në figurë tregojnë se rrugët që kryqëzohen, për momentin janë të bllokuara.	146	Gabim
3071	Panelet plotësuese në figurë tregojnë vazhdimin e rrugës dytësore dhe ndërprerjen e saj me rrugë me përparësi.	147	Saktë
3072	Paneli plotësues A në figurë tregon se jemi në rrugë dytësore që ndërpritet me rrugë kryesore.	147	Saktë
3073	Panelet plotësuese në figurë tregojnë që po afrohemi në një rrugë me një sens lëvizjeje.	147	Gabim
3074	Kur nis mjetin nga vendi, drejtuesi duhet të sigurohet që rruga është e lirë, duke kontrolluar edhe me pasqyrat e mjetit.		Saktë
3075	Me nisjen e mjetit nga vendi, para se të hymë në trafik, duhet t'u japim përparësi mjeteve që qarkullojnë në rrugë.		Saktë
3076	Për nisjen e mjetit nga vendi duhet të çaktivizojmë frenin e dorës në momentin që fillohet lëvizja e mjetit.		Saktë
3077	Para se të nisim lëvizjen me mjet duhet që të vendosen rripat e sigurimit.		Saktë
3078	Para nisjes nga vendi me ciklomotor, motor ose motor me kosh duhet të vendoset kaska mbrojtëse.		Saktë
3079	Sapo nisemi me mjet nga vendi, duhet të futemi në rrjedhën e trafikut dhe pastaj të ndezim sinjalin tregues të drejtimit.		Gabim
3080	Kur nis mjetin nga vendi, drejtuesi duhet të ndezë sinjalin tregues të drejtimit vetëm nëse ka mjete që vijnë nga pas.		Gabim
3081	Kur nis mjetin nga vendi, drejtuesi duhet të shkelë pedalin e gazit deri në fund dhe të lirojë menjëherë pedalin e friksionit që të niset sa më shpejt.		Gabim
3082	Para nisjes me mjet, drejtuesi i mjetit duhet të rregullojë pozicionin e ndenjësës së tij, për ta përshtatur me trupin.		Saktë
3083	Para nisjes me mjet, drejtuesi i mjetit duhet të rregullojë pasqyrat, për një shikim sa më të mirë anash dhe mbrapa.		Saktë
3084	Para nisjes me mjet, drejtuesi i mjetit duhet të sistemojë objektet e mundshme brenda mjetit për të shmangur zhvendosjen e tyre gjatë lëvizjes.		Saktë
3085	Drejtuesi i mjetit, gjatë lëvizjes, duhet të mbajë gjithmonë dorën e djathtë mbi levën e marshit për të rritur sigurinë në qarkullim.		Gabim



3086	Drejtuesi i mjetit mund të flasë me celular duke mbajtur timonin me një dorë.	Gabim
3087	Drejtuesi i mjetit, gjatë lëvizjes në një rrugë të drejtë, duhet të kthejë kokën prapa për të rritur sigurinë në qarkullim.	Gabim
3088	Kur lëvizet mbrapsht (indietro) duhet t'u jepet përparësi mjeteve që vijnë si nga e djathta ashtu dhe nga e majta.	Saktë
3089	Kur lëvizet mbrapsht (indietro) drejtuesi i mjetit duhet të tregojë kujdes ndaj këmbësorëve që lëvizin prapa mjetit.	Saktë
3090	Për të hyrë në qarkullim me marshin e lëvizjes prapa (indietro) drejtuesi i mjetit duhet të sigurohet që rruga është e lirë dhe të manovrojë me kujdes mjetin.	Saktë
3091	Për të hyrë në qarkullim me marshin e lëvizjes prapa (indietro), drejtuesi i mjetit duhet të verë në veprim sinjalizimin e ndritshëm të rrezikut.	Gabim
3092	Për të hyrë në qarkullim me marshin e lëvizjes prapa (indietro), drejtuesi i mjetit duhet të manovrojë me shumë shpejtësi që të dalë nga zona e parkimit sa më parë.	Gabim
3093	Për të hyrë në qarkullim me marshin e lëvizjes prapa (indietro), duhet të sinjalizohet vazhdimisht me bori për kryerjen e manovrës.	Gabim
3094	Drejtuesi i mjetit duhet të niset për udhëtim në kushte të mira fizike.	Saktë
3095	Drejtuesi i mjetit duhet të kontrollojë gjendjen e gomave para nisjes për udhëtim.	Saktë
3096	Drejtuesi i mjetit duhet të bëjë ndalesa të ndërmjetme në udhëtimet e gjata.	Saktë
3097	Drejtuesi i mjetit duhet të fryjë gomat me një presion pak me të ulët nga ajo e rekomanduar prej prodhuesit..	Gabim
3098	Para se të zbresim nga mjeti, duhet të sigurohemi nëpërmjet pasqyrave, për të shmangur rreziqet e mundshme.	Saktë
3099	Para se të zbresim nga mjeti, duhet të sigurohemi që e kemi parkuar mjetin në mënyrë korrekte.	Saktë
3100	Para se të zbresim nga mjeti, duhet të sigurohemi që nuk e pengojmë trafikun.	Saktë
3101	Para se të zbresim nga mjeti, duhet të aktivizojmë frenin e dorës.	Saktë
3102	Para se të zbresim nga mjeti, duhet të sigurohemi që e kemi fikur motorin e mjetit.	Saktë
3103	Para se të zbresim nga mjeti, duhet të sigurohemi që hapja e dyerve nuk përbën rrezik për përdoruesit e tjerë të rrugës.	Saktë
3104	Para se të zbresim nga mjeti, duhet të lëmë levën e marshit në pozicionin neutral.	Gabim
3105	Para se të zbresim nga mjeti, duhet të kërkojmë e të pyesim punonjës të trafikut nëse lejohet parkimi në atë vend.	Gabim



3106	Sa herë që e lëmë mjetin pushim në rrugë duhet të aktivizojmë frenin e dorës (qëndrimin).	Saktë
3107	Drejtuesi që e le mjetin pushim në rrugë, duhet të sigurohet që e ka fikur motorin.	Saktë
3108	Për ta lënë mjetin pushim, duhet të sigurohemi më parë për të gjetur vendin e lejuar.	Saktë
3109	Drejtuesi që e le mjetin pushim në rrugë, duhet ta vendosë levën e marshit në pozicionin neutral.	Gabim
3110	Drejtuesi që e le mjetin pushim në rrugë duhet që në orët e mbrëmjes, të lërë gjithmonë ndezur dritat e pozicionit edhe pse është jashtë karrexhatës.	Gabim
3111	Drejtuesi që e le mjetin pushim në rrugë, duhet që në qendrat e banuara ku s'ka trotuar, ta vendosë mjetin sa më në anë të rrugës nga e djathta pa lënë fare hapësirë.	Gabim
3112	Drejtuesi që e le mjetin pushim në rrugë, duhet të vendosë marshin më të lartë të lëvizjes.	Gabim
3113	Qëndrimi i mjetit është një ndërprerje e lëvizjes së mjetit për një kohë të shkurtër, me kusht që drejtuesi i mjetit të jetë i pranishëm dhe i gatshëm për të rifilluar lëvizjen.	Saktë
3114	Qëndrimi i mjetit lejohet si rregull përgjatë krahut të djathtë të karrexhatës.	Saktë
3115	Ndalohet qëndrimi i mjetit në autostrada, me përjashtim të rasteve të emergjencës.	Saktë
3116	Ndalohet qëndrimi i mjetit në vendkalimet e këmbësorëve.	Saktë
3117	Ndalohet qëndrimi i mjetit në vazhdimësi të "KALIMEVE NË NIVEL".	Saktë
3118	Qëndrimi i mjetit nuk duhet të shkaktojë pengesa për qarkullimin.	Saktë
3119	Ndalohet qëndrimi i mjetit përballë sinjaleve rrugore nëse bëhet pengesë për dukshmërinë e tyre.	Saktë
3120	Ndalohet qëndrimi i mjetit në afërsi dhe në vazhdimësi të kryqëzimeve të rrugëve interurbane.	Saktë
3121	Ndalohet qëndrimi i mjetit mbi linjat e tramvajeve.	Saktë
3122	Ndalohet qëndrimi i mjetit aty ku ka sinjalizime horizontale të përzgjedhjes së korsive.	Saktë
3123	Ndalohet qëndrimi i mjetit mbi vendkalimet e këmbësorëve.	Saktë
3124	Ndalohet qëndrimi i mjetit mbi vendkalimet e biçikletave.	Saktë
3125	Lejohet qëndrimi i mjetit për një kohë të shkurtër në kurrize rruge.	Gabim



3126	Lejohet qëndrimi i mjetit për një kohë të shkurtër në kthesat e rrugëve me një korsi për çdo sens lëvizjeje.	Gabim
3127	Lejohet qëndrimi i mjetit në prani të sinjalit “Ndalim qëndrimi”.	Gabim
3128	Ndalohet qëndrimi i mjetit kur jemi në rrugë të drejtë.	Gabim
3129	Ndalohet qëndrimi i mjetit në krahun e djathtë të karrexhatës.	Gabim
3130	Ndalohet qëndrimi i mjetit pranë stacioneve të autobusëve.	Gabim
3131	Ndalohet qëndrimi i mjetit për të hipur e zbritur pasagjerët, në çdo vend ku shkakton pengesa për trafikun.	Saktë
3132	Ndalohet qëndrimi i mjetit për të hipur e zbritur pasagjerët, në rrugët interurbane, në afërsi dhe në vazhdimësi të kryqëzimeve.	Saktë
3133	Ndalohet qëndrimi i mjetit për të hipur e zbritur pasagjerët, në vazhdimësi të “KALIMEVE NË NIVEL”.	Saktë
3134	Ndalohet qëndrimi i mjetit për të hipur e zbritur pasagjerët, mbi shinat e tramvajeve.	Saktë
3135	Ndalohet qëndrimi i mjetit për të hipur e zbritur pasagjerët, në orët e natës.	Gabim
3136	Ndalohet qëndrimi i mjetit për të hipur e zbritur pasagjerët, në zonat urbane, në rast shiu.	Gabim
3137	Ndalohet pushimi i mjetit poshtë këmbëve të urave, harqeve dhe portave rrugore, përveç rasteve kur sinjalizohet ndryshe.	Saktë
3138	Ndalohet pushimi i mjetit në vendet e caktuara për pushimin e mjeteve të invalidëve.	Saktë
3139	Ndalohet pushimi i mjetit në korsitë e rezervuara për mjetet e transportit publik.	Saktë
3140	Ndalohet pushimi i mjetit në zonat e lëvizjes për këmbësorët.	Saktë
3141	Ndalohet pushimi i mjetit mbi shinat e tramvajeve.	Saktë
3142	Ndalohet pushimi i mjetit në pistat e rezervuara për biçiklistët.	Saktë
3143	Ndalohet pushimi i mjetit në vazhdimësi të kryqëzimeve në nivel.	Saktë
3144	Ndalohet pushimi i mjetit në zonat e përcaktuara për pushimin apo qëndrimin e mjeteve taksi.	Saktë
3145	Ndalohet pushimi i mjetit në korsitë e përzgjedhjes.	Saktë
3146	Ndalohet pushimi i mjetit në vazhdimësi të një kthese, jashtë qendrave të banuara.	Saktë



3147	Ndalohet pushimi i mjetit në kurrize rruge të rrugëve interurbane dhe urbane kryesore.	Saktë
3148	Ndalohet pushimi i mjetit në vendin ku janë vendosur kazanët e mbeturinave në rrugë.	Saktë
3149	Ndalohet pushimi i mjetit në afërsi të pikave të karburantit (më afër se 5 metër nga instalimet e destinuar për furnizim).	Saktë
3150	Ndalohet pushimi i mjetit në anë të karrexhatës në raste shiu të fortë.	Gabim
3151	Ndalohet pushimi i mjetit në rrugët me borë.	Gabim
3152	Ndalohet pushimi i mjetit në zonat e shërbimit të autostradave.	Gabim
3153	Ndalohet pushimi i mjetit në bankinë përveç rasteve kur lejohet me sinjalizim.	Saktë
3154	Ndalohet pushimi i mjetit në zonat e kryqëzimeve të rregulluara me semafor dhe në afërsi të tyre.	Saktë
3155	Ndalohet pushimi i mjetit në zonat urbane, nga ora 8:00 deri në 20:00, në prani të sinjalit ndalim pushimi.	Saktë
3156	Ndalohet pushimi i mjetit në afërsi të sinjaleve rrugore, nëse bëhet pengesë për shikueshmërinë e tyre.	Saktë
3157	Ndalohet pushimi i mjetit në zonat e rezervuara për qëndrimin e autobusëve.	Saktë
3158	Ndalohet pushimi i mjetit para hyrjeve të garazheve.	Saktë
3159	Ndalohet pushimi i mjetit në tunele.	Saktë
3160	Ndalohet pushimi i mjetit në rrugët me një sens lëvizjeje për qarkullimin në rrugë urbane.	Gabim
3161	Ndalohet pushimi i mjetit jashtë qendrave të banuara.	Gabim
3162	Ndalohet pushimi i mjetit në zonat e parkimit të lejuar.	Gabim
3163	Ndalohet pushimi i mjetit në çdo rast, në krahun e djathtë të karrexhatës.	Gabim
3164	Ndalohet pushimi i mjetit në qendrat e banuara.	Gabim
3165	Ndalohet pushimi i mjeteve në korsitë e rezervuara për qarkullimin e mjeteve të shërbimit publik.	Saktë
3166	Ndalohet pushimi i mjeteve në pistat e biçikletave.	Saktë
3167	Ndalohet pushimi i mjeteve mbi ishujt e trafikut.	Saktë



3168	Ndalohet pushimi i mjeteve mbi e bankina rrugësh, përveç rasteve kur lejohet pushimi me sinjalizim.	Saktë
3169	Ndalohet pushimi i automjeteve dhe motorëve me drejtim të ndryshëm nga ato që udhëzojnë vijëzimet për parkimin e mjeteve kur zen më shumë se një vend.	Saktë
3170	Ndalohet pushimi i mjeteve në kurrize rrugësh apo në afërsi të tyre, jashtë qendrave të banuara.	Saktë
3171	Ndalohet pushimi i mjeteve në çdo rast në afërsi të sinjaleve rrugore.	Gabim
3172	Ndalohet pushimi i mjeteve në qendrat e banuara, kur nuk ka vijëzime të rrugës.	Gabim
3173	Ndalohet pushimi i mjeteve në vendet ku pushimi është i lejuar me kohë të kufizuar.	Gabim
3174	Ndalohet pushimi i mjeteve në rresht të dytë përveç rasteve kur mjetet janë me dy rrota.	Saktë
3175	Ndalohet pushimi i automjeteve në rresht të dytë.	Saktë
3176	Ndalohet pushimi i automjeteve në rresht të dytë vetëm nëse shkakton rrezik për qarkullimin.	Gabim
3177	Ndalohet pushimi i mjeteve në rresht të dytë në rastin kur mjetet janë me dy rrota.	Gabim
3178	Shiritat verdhë e zi të vizatuar në bordurën e trotuarit ndalojnë pushimin e mjeteve.	Saktë
3179	Ndalohet pushimi i mjeteve në zonën e kufizuar me vijë të verdhë të pandërprerë brenda të cilës është shënuar fjala "BUS" (autobus).	Saktë
3180	Ndalohet pushimi i mjeteve në zonën ku është vendosur sinjali "PARKIM".	Gabim
3181	Vend parkimi i autorizuar për mjetet "TAKSI" kufizohet me vijë të verdhë.	Saktë
3182	Kur dalim nga parkimi i autorizuar duhet t'u japim përparësi mjeteve që janë në qarkullim.	Saktë
3183	Vendparkimi i autorizuar kufizohet me vijë të verdhë, kur parkimi është me pagesë.	Gabim
3184	Vendparkimi i autorizuar, kur është i kufizuar me vijë blu, lejon parkimin vetëm për mjetet "TAKSI".	Gabim
3185	Kur mjeti vendoset në parkim, drejtuesi duhet të sigurohet që mjeti nuk përbën rrezik për qarkullimin.	Saktë
3186	Gjatë pushimit mjeti duhet të jetë me motor të fikur.	Saktë
3187	Kur parkojmë duhet që mjetin ta pozicionojmë sa më afër bordurës së trotuarit, për të mos penguar qarkullimin.	Saktë
3188	Gjatë pushimit mjeti duhet të ketë të aktivizuara frenat e qëndrimit (frenat e dorës).	Saktë



3189	Gjatë pushimit në vendet e lejuara për parkim, mjete duhet të vendoset sipas sinjalizimit horizontal të përcaktuar.		Saktë
3190	Kur parkojmë në vendet ku nuk ka trotuar, mjete duhet të vendoset duke lënë një hapësirë, të paktën një metër për kalimtarët.		Saktë
3191	Kur parkojmë në vendet e pushimit me orar, duhet të aktivizojmë treguesin e orarit (diskun orar aty ku aplikohet).		Saktë
3192	Gjatë pushimit, dritat e pozicionit duhen të lihen të ndezura në çdo rast.		Gabim
3193	Gjatë pushimit në rresht të dytë, mjete duhet të lihet duke aktivizuar sinjalin e emergjencës.		Gabim
3194	Kur parkojmë mjetin në një të përpjetë (pjerrësi ngjitëse), duhet të kujdesemi që leva e marshit të ingranohet në marshin me të lartë.		Gabim
3195	Mjete mund të parkohet duke vendosur rrotat e krahut të djathtë mbi trotuar, kur lihet hapësirë e mjaftueshme për kalimtarët.		Gabim
3196	Sinjali në figurë tregon një zonë të caktuar për pushimin e mjeteve pa kufizim kohor.	86	Saktë
3197	Sinjali në figurë i shoqëruar me panel plotësues tregon se lejohet pushimi, por sipas kushteve të vendosur në panel.	86	Saktë
3198	Sinjali në figurë tregon zonë pushimi me pagesë.	86	Gabim
3199	Sinjali në figurë tregon një parkim me pagesë, pa kufizime në kohë por me tarifë orare.	87	Saktë
3200	Sinjali në figurë është i zbatueshëm vetëm për autoveturat.	87	Gabim
3201	Sinjali në figurë tregon një vend parkimi me pagesë fikse.	88	Saktë
3202	Sinjali në figurë tregon një vend parkimi, me orare të përcaktuara dhe pagesë fikse.	88	Saktë
3203	Sinjali në figurë është i zbatueshëm vetëm për automjetet e transportit publik.	88	Gabim
3204	Sinjali në figurë tregon një vendparkim që gjendet në drejtimin e shigjetës.	89	Saktë
3205	Sinjali në figurë tregon se pas 300 metër në drejtimin e shigjetës, ndodhet një vendparkim.	89	Saktë
3206	Sinjali në figurë paralajmëron një parkim që gjendet pas 300 m.	89	Saktë
3207	Sinjali në figurë paralajmëron një pikë të ndihmës së shpejtë në drejtim të shigjetës.	89	Gabim
3208	Sinjali në figurë paralajmëron ndalim pushimi për mjetet në drejtim të shigjetës.	89	Gabim
3209	Sinjali në figurë paralajmëron një parkim të rezervuar vetëm për autobusë, në distancë 300 metër.	89	Gabim



3210	Simboli në figurë bëhet i dukshëm, me ngjyrë blu ne kroskot, kur ndizen fenerët e largësisë.	695	Saktë
3211	Simboli në figurë bëhet i dukshëm, me ngjyrë të verdhë ne kroskot, kur ndizen fenerët e largësisë.	695	Gabim
3212	Simboli në figurë bëhet i dukshëm, me ngjyrë jeshile ne kroskot, kur ndizen fenerët joverbues.	696	Saktë
3213	Simboli në figurë bëhet i dukshëm, me ngjyrë jeshile ne kroskot, kur ndizen fenerët e largësisë.	696	Gabim
3214	Simboli në figurë bëhet i dukshëm, me ngjyrë jeshile ne kroskot, kur ndizen fenerët e pasmë të mjegullës.	696	Gabim
3215	Simboli në figurë bëhet i dukshëm, me ngjyrë jeshile ne kroskot, kur ndizen fenerët e përparme të mjegullës.	696	Gabim
3216	Shigjeta majtas, e simbolit në figurë, bëhet e dukshme në kroskot me ngjyrë jeshile që pulson, kur ndizet sinjali i drejtimit majtas.	697	Saktë
3217	Simboli në figurë bëhet i dukshëm, me ngjyrë jeshile pulsuese ne kroskot, kur ndizen dritat e emergjencës.	697	Saktë
3218	Simboli në figurë bëhet i dukshëm, me ngjyrë jeshile pulsuese në kroskot, kur ndizen dritat e pozicionit.	697	Gabim
3219	Simboli i paraqitur në figurë me dritë të kuqe ndezur tregon se janë ndezur dritat e emergjencës.	698	Saktë
3220	Simboli i paraqitur në figurë me dritë të kuqe ndezur tregon se janë ndezur fenerët e largësisë.	698	Gabim
3221	Simboli në figurë vendoset mbi komandën që aktivizon fshirëset e xhamit të përparmë.	699	Saktë
3222	Simboli në figurë vendoset mbi komandën që aktivizon fshirëset e xhamit të pasmë.	699	Gabim
3223	Simboli i paraqitur në figurë vendoset mbi çelësin që komandon fshirjen dhe larjen e xhamit të përparmë.	701	Saktë
3224	Simboli i paraqitur në figurë vendoset mbi çelësin që komandon larjen e xhamit të pasmë.	701	Gabim
3225	Simboli i paraqitur në figurë vendoset mbi butonin që aktivizon sinjalin zanor të mjetit (boria).	702	Saktë
3226	Simboli i paraqitur në figurë ndizet sa herë që ka defekt në pajisjen e sinjalizimit zanor (borisë).	702	Gabim
3227	Kur llamba spiune e simbolit në figurë është e ndezur, tregon që mjeti është me rezervën e karburantit.	703	Saktë
3228	Simboli i paraqitur në figurë tregon se ndalohet duhani.	703	Gabim
3229	Simboli në figurë bëhet i dukshëm në kroskot, kur temperatura e lëngut ftohës që qarkullon në motor rritet mbi normën e lejuar.	704	Saktë
3230	Simboli në figurë bëhet i dukshëm në kroskot, kur temperatura e vajit lubrifikues që qarkullon në motor rritet mbi normën e lejuar.	704	Gabim



3231	Simboli në figurë bëhet i dukshëm në kroskot kur dinamoja nuk çon rrymë te bateria.	705	Saktë
3232	Simboli në figurë bëhet i dukshëm në kroskot kur kemi një defekt në sistemin e shpërndarjes së karburantit.	705	Gabim
3233	Nëse llamba spiune e simbolit të paraqitur në figurë është e fikur gjatë lëvizjes me mjet, presioni i vajit në motor është në vlera normale.	706	Saktë
3234	Simboli në figurë bëhet i dukshëm në kroskot kur presioni i vajit lubrifikues në motor është i pamjaftueshëm.	706	Saktë
3235	Simboli në figurë bëhet i dukshëm në kroskot kur ka defekt në frena.	706	Gabim
3236	Simboli në figurë bëhet i dukshëm në kroskot kur nuk është vënë rripi i sigurimit.	707	Saktë
3237	Kur drejtuesi i mjetit dhe pasagjeri vendosin rripin e sigurimit, llamba mbi të cilën është vendosur sinjali në figurë fiket.	707	Saktë
3238	Simboli në figurë bëhet i dukshëm në kroskot kur pasagjeri nuk ka vendosur rripin e sigurimit.	707	Saktë
3239	Simboli në figurë bëhet i dukshëm në kroskot kur drejtuesi i mjetit dhe pasagjeri kanë vënë rripin e sigurimit.	707	Gabim
3240	Simboli në figurë bëhet i dukshëm në kroskot kur rezistencat termike të xhamit të pasmë janë në punë.	708	Saktë
3241	Simboli në figurë bëhet i dukshëm në kroskot kur ventilimi apo ngrohja e xhamit të përparmë është në funksion.	708	Gabim
3242	Simboli në figurë bëhet i dukshëm në kroskot kur ventilimi apo ngrohja e xhamit të përparmë janë në funksion.	709	Saktë
3243	Simboli në figurë bëhet i dukshëm në kroskot kur rezistenca termike e xhamit të pasmë është në funksion.	709	Gabim
3244	Simboli i paraqitur në figurë vendoset mbi komandën e pajisjes që shkrin veshjen e xhamit të pasmë nga ngrica.	709	Gabim
3245	Simboli në figurë bëhet i dukshëm, me dritë jeshile në kroskot, kur janë të ndezura dritat e pozicionit.	713	Saktë
3246	Simboli në figurë tregon vendin e komandimit të dritave të kabinës.	713	Gabim
3247	Simboli në figurë vendoset mbi çelësin e komandimit të dritave të gjata.	713	Gabim
3248	Simboli në figurë tregon vendin e komandimit të sinjaleve.	714	Gabim
3249	Simboli në figurë tregon vendin e komandimit të dritave të parkimit.	715	Saktë
3250	Simboli në figurë vendoset mbi çelësin e komandimit të fenerëve verbues.	715	Gabim
3251	Simboli në figurë bëhet i dukshëm në kroskot kur ingranohet marshi i lëvizjes prapa.	716	Saktë



3252	Simboli në figurë tregon vendin e komandimit të dritave të pasme të mjetit.	716	Gabim
3253	Simboli në figurë bëhet i dukshëm në kroskot kur janë të ndezura dritat e pasme për mjegullën.	717	Saktë
3254	Simboli në figurë bëhet i dukshëm në kroskot kur janë ndezur fenerët e përparmë mjegullçarës.	718	Saktë
3255	Simboli i paraqitur në figurë tregon komandën që ndez fenerët e pasmë kundër mjegullës.	718	Gabim
3256	Simboli në figurë bëhet i dukshëm në kroskot kur ndizen dritat e pasme kundër mjegullës.	718	Gabim
3257	Simboli në figurë tregon vendin e komandimit të çelësit të larësit të fenerëve.	719	Saktë
3258	Simboli në figurë tregon vendin e komandimit të dritave të kabinës.	719	Gabim
3259	Simboli në figurë tregon vendin e komandimit të dritave të gjata.	719	Gabim
3260	Simboli në figurë bëhet i dukshëm në kroskot kur rimorkiojmë një mjet me defekt.	719	Gabim
3261	Kur freni i dorës është i aktivizuar, në kroskot ndizet simboli i paraqitur në figurë.	720	Saktë
3262	Simboli në figurë bëhet i dukshëm në kroskot kur aktivizohet freni i dorës.	720	Saktë
3263	Simboli në figurë bëhet i dukshëm në kroskot kur ndizen dritat e pozicionit.	720	Gabim
3264	Simboli në figurë bëhet i dukshëm në kroskot kur ingranohet marshi i lëvizjes prapa.	720	Gabim
3265	Kur ferrotat e frenave konsumohen më shumë se norma e lejuar, ndizet llamba që bën të dukshëm në kroskot simbolin e paraqitur në figurë.	721	Saktë
3266	Kur nivelit i lëngut të frenave në sistem bie nën nivelin e lejuar, ndizet llamba që bën të dukshëm në kroskot simbolin e paraqitur në figurë.	721	Saktë
3267	Kur në kroskot ndizet llamba që bën të dukshëm simbolin e paraqitur në figurë, duhet të kontrollohet sistemi i frenimit.	721	Saktë
3268	Simboli në figurë bëhet i dukshëm në kroskot kur ndonjë nga dyert e mjetit nuk është mbyllur mirë.	721	Gabim
3269	Targa e pasme duhet të jetë e ndriçuar natën për të qenë e dallueshme.		Saktë
3270	Targa e pasme duhet të jetë e ndriçuar sapo të ndizen dritat e pozicionit.		Saktë
3271	Targa e pasme duhet të jetë e ndriçuar edhe kur mjeti është në parkim.		Gabim
3272	Përdorimi i sistemeve të sinjalizimit pamor është i detyrueshëm vetëm ditën.		Gabim



3273	Përdorimi i sistemeve të sinjalizimit pamor është i detyrueshëm gjatë gjithë kohës së lëvizjes, pavarësisht llojit të rrugës.	Gabim
3274	Përdorimi i sistemeve të sinjalizimit pamor është i detyrueshëm vetëm kur lëvizim në rrugë urbane.	Gabim
3275	Përdorimi i dritave të pozicionit është i detyrueshëm natën, gjatë qëndrimit apo pushimit në karrexhatë, kur mungon ndriçimi publik.	Saktë
3276	Përdorimi i dritave të pozicionit është i detyrueshëm edhe kur mjete gjendet në korsinë e emergjencës, natën.	Saktë
3277	Dritat e pozicionit janë të ndezur në rastet kur janë në funksionim fenerët e largësisë, fenerët joverbues apo dritat kundër mjegullës.	Saktë
3278	Përdorimi i dritave të pozicionit është i detyrueshëm kur mjete është parkuar jashtë karrexhatës.	Gabim
3279	Përdorimi i dritave të pozicionit është i detyrueshëm vetëm në rastet kur mjetit gjendet në korsinë e emergjencës.	Gabim
3280	Fenerët joverbues shërbejnë për të ndriçuar rrugën, pa shkaktuar verbim.	Saktë
3281	Përdorimi i fenerëve joverbues gjatë qarkullimit është i detyrueshëm edhe ditën, kur transportojmë të aksidentuar.	Saktë
3282	Përdorimi i fenerëve joverbues (dritat e shkurtra) gjatë qarkullimit në rrugë interurbane është i detyrueshëm edhe ditën.	Saktë
3283	Përdorimi i fenerëve joverbues (dritat e shkurtra) gjatë qarkullimit në autostradë është i detyrueshëm edhe ditën.	Saktë
3284	Përdorimi i fenerëve joverbues (dritat e shkurtra) gjatë qarkullimit në tunele është i ndaluar.	Gabim
3285	Përdorimi i fenerëve joverbues (dritat e shkurtra) gjatë qarkullimit në qendrat e banuara është i ndaluar.	Gabim
3286	Përdorimi i fenerëve joverbues ditën është i lejuar vetëm në raste emergjence.	Gabim
3287	Kur lëvizim natën në rrugë interurbane dhe këmbehemi me mjete të tjera, duhet të fikim fenerët e largësisë dhe të përdorim fenerët joverbues.	Saktë
3288	Natën, në rrugët interurbane, kur ndjekim një mjet tjetër në distancë të afërt, duhet të fikim fenerët e largësisë dhe të përdorim fenerët joverbues.	Saktë
3289	Natën, në rrugët interurbane, kur është i pranishëm rreziku që të verbojmë përdoruesit e tjerë të rrugës, duhet të fikim fenerët e largësisë dhe të përdorim fenerët joverbues.	Saktë
3290	Natën, në rrugët interurbane, kur ka rrezik të verbojmë drejtuesit e mjeteve në karrexhatën tjetër, duhet të fikim fenerët e largësisë dhe të përdorim fenerët joverbues.	Saktë
3291	Përdorimi i fenerëve të largësisë është i ndaluar në qendrat e banuara.	Saktë
3292	Përdorimi i fenerëve të largësisë me ndërprerje në intervale të shkurtra, lejohet për të sinjalizuar një parakalim.	Saktë



3293	Përdorimi i fenerëve të largësisë me ndërprerje në intervale të shkurtra, lejohet për të sinjalizuar një situatë të mundshme rreziku.	Saktë
3294	Përdorimi i fenerëve të largësisë lejohet në qendrat e banuara, në kushtet e mjegullës së dendur.	Gabim
3295	Përdorimi i sinjaleve treguese të drejtimit është i detyrueshëm kur kryejmë manovrën e parakalimit.	Saktë
3296	Përdorimi i sinjaleve treguese të drejtimit është i detyrueshëm kur duam të ndryshojmë korsinë e lëvizjes.	Saktë
3297	Përdorimi i sinjaleve treguese të drejtimit është i detyrueshëm kur kryejmë manovrën e kthimit të drejtimit të lëvizjes.	Saktë
3298	Përdorimi i sinjaleve treguese të drejtimit është i detyrueshëm kur futemi në një karrexhatë përmes korsisë së shpejtimit.	Saktë
3299	Përdorimi i sinjaleve treguese të drejtimit është i detyrueshëm kur kemi ndërmend të ndalojmë mjetin jashtë karrexhatës.	Saktë
3300	Përdorimi i sinjaleve treguese të drejtimit është i detyrueshëm kur dalim nga rruga për të hyrë në një korsi ngadalësimi.	Saktë
3301	Përdorimi i sinjaleve treguese të drejtimit është i detyrueshëm kur nisemi nga vendi për të hyrë në qarkullim.	Saktë
3302	Përdorimi i sinjaleve treguese të drejtimit është i detyrueshëm kur ndalojmë për shkak të ndërprerjes së qarkullimit.	Gabim
3303	Përdorimi i sinjaleve treguese të drejtimit është i detyrueshëm kur lëvizim në rreshta paralelë.	Gabim
3304	Përdorimi i sinjaleve treguese të drejtimit është i detyrueshëm kur lëvizim drejt në tunel.	Gabim
3305	Përdorimi i sinjaleve treguese të drejtimit është i detyrueshëm kur kërkojmë të lëvizim drejt në kryqëzim.	Gabim
3306	Drejtuesit e mjeteve me motor duhet të aktivizojnë sinjalizimin e ndritshëm të rrezikut në rastet e zënies së karrexhatës, për shkaqe emergjence.	Saktë
3307	Drejtuesit e mjeteve me motor duhet të aktivizojnë sinjalizimin e ndritshëm të rrezikut, gjatë kohës që ndalojnë për të vendosur apo rimarrë trekëndëshin e rrezikut.	Saktë
3308	Drejtuesit e mjeteve me motor duhet të aktivizojnë sinjalizimin e ndritshëm të rrezikut, kur janë të detyruar të lëvizin me shpejtësi të ulët, për shkak të defektit në mjet.	Saktë
3309	Drejtuesit e mjeteve me motor duhet të aktivizojnë sinjalizimin e ndritshëm të rrezikut, kur në rrugë verifikohen ngadalësime të papritura për shkak të vargut të mjeteve.	Saktë
3310	Drejtuesit e mjeteve me motor duhet të aktivizojnë sinjalizimin e ndritshëm të rrezikut kur qëndrimi i emergjencës mund të shkaktojë rrezik për përdoruesit e rrugës.	Saktë
3311	Drejtuesit e mjeteve me motor duhet të aktivizojnë sinjalizimin e ndritshëm të rrezikut kur mendojmë se mjetet që vinë pas, nuk ruajnë distancën e sigurisë.	Gabim
3312	Drejtuesit e mjeteve me motor duhet të aktivizojnë sinjalizimin e ndritshëm të rrezikut, kur nuk funksionon ndonjë prej dritave të pozicionit.	Gabim



3313	Drejtuesit e mjeteve me motor duhet të aktivizojnë sinjalizimin e ndritshëm të rrezikut, kur lëvizin në rreshta paralele jashtë qendrave të banuara.	Gabim
3314	Ndalohet përdorimi i pajisjeve të sinjalizimit zanor (borive) në qendrat e banuara, përveç rasteve të rreziqeve të papritura.	Saktë
3315	Lejohet përdorimi i pajisjeve të sinjalizimit zanor (boritë) në qendrat e banuara, kur transportohen të plagosur ose të sëmurë rëndë.	Saktë
3316	Pajisjet e sinjalizimit zanor (boritë) mund të përdoren jashtë qendrave të banuara, në rastet e parakalimeve.	Saktë
3317	Pajisjet e sinjalizimit zanor (boritë) si rregull janë të ndaluara të përdoren në qendrat e banuara.	Saktë
3318	Pajisjet e sinjalizimit zanor (boritë) lejohen të përdoren në rrugë urbane, veçanërisht natën.	Gabim
3319	Sinjalizimi zanor (boria) duhet përdorur me kohëzgjatje sa më të madhe që të jetë e mundur.	Gabim
3320	Pajisjet e sinjalizimit zanor (boritë) mund të përdoren pa ndërprerje nga automjetet e ndihmës së shpejtë edhe kur janë jashtë shërbimit.	Gabim
3321	Pajisjet e sinjalizimit zanor (boritë) përdoren kryesisht kur bllokohet trafiku.	Gabim
3322	Pajisjet e sinjalizimit zanor (boritë) ndalohen të përdoren në rrugët interurbane kryesore.	Gabim
3323	Leja e qarkullimit të mjetit është dokument i nevojshëm për qarkullim me mjet.	Saktë
3324	Lejedrejtimi, e vlefshme për kategorinë përkatëse të mjetit, është dokument i nevojshëm për qarkullim me mjet.	Saktë
3325	Certifikata e Kontrollit Teknik të mjetit është dokument i nevojshëm për qarkullim me mjet.	Saktë
3326	Certifikata e sigurimit të detyruar është dokument i nevojshëm për qarkullim me mjet.	Saktë
3327	Kontrata e blerjes së mjetit është dokument që duhet mbajtur detyrimisht në mjet.	Gabim
3328	Dokumenti i origjinës apo i prejardhjes së mjetit është dokument që duhet mbajtur në mjet.	Gabim
3329	Dokumenti i zhdoganimit të mjetit është dokument që duhet mbajtur në mjet.	Gabim
3330	Certifikata e pronësisë së mjetit është dokument që duhet mbajtur në mjet.	Gabim
3331	Traktorët bujqësorë pajisen me leje qarkullimi dhe targa regjistrimi.	Saktë
3332	Një nga kushtet për t'u pajisur me lejedrejtimi është plotësimi i kërkesave fizike e psikike, që vërtetohen me certifikatë mjekësorë të gjashtë muajve të fundit.	Saktë
3333	Një nga kushtet për t'u pajisur me lejedrejtimi të kategorisë A1 ose A2 është që personi të ketë mbushur moshën 18 vjeç.	Saktë



3334	Një nga kushtet për t'u pajisur me lejedrejtimi të kategorisë B1 është që personi të ketë mbushur moshën 18 vjeç.	Saktë
3335	Një nga kushtet për t'u pajisur me lejedrejtimi të kategorisë A është që kandidati të ketë mbushur moshën 16 vjeç.	Gabim
3336	Një nga kushtet për t'u pajisur me lejedrejtimi të kategorisë B është që kandidati të ketë mbushur moshën 21 vjeç.	Gabim
3337	Një nga kushtet për t'u pajisur me lejedrejtimi është që kandidati të ketë mbushur moshën 21 vjeç, për të drejtuar autovetura me (8+1) vende.	Gabim
3338	Me lejedrejtimi të kategorisë A1 lejohet të drejtosh motor me ose pa kosh, me cilindratë deri në 125 cm ³ .	Saktë
3339	Me lejedrejtimi të kategorisë A lejohet të drejtosh motorë dhe motomjete të tjerë me fuqi më të madhe se 15 kw.	Saktë
3340	Me lejedrejtimi të kategorisë B lejohet të drejtosh automjete me peshe maksimale jo më të madhe se 3500 kg dhe me jo më shumë se 9 ndenjëse, përfshirë edhe atë të drejtuesit të mjetit.	Saktë
3341	Me lejedrejtimi të kategorisë BE lejohet të drejtosh kombinimin e një mjeti të kategorisë B me një rimorkio ose gjysmërimorkio, ku masa maksimale e rimorkios ose gjysmërimorkios nuk i kalon 3 500 kg.	Saktë
3342	Me lejedrejtimi të kategorisë B lejohet të drejtosh të gjithë llojet e motorëve.	Gabim
3343	Me lejedrejtimi të kategorisë B lejohet të drejtosh kamionë me peshë me ngarkesë deri 4 tonë.	Gabim
3344	Me lejedrejtimi të kategorisë A lejohet të drejtosh autovetura me cilindrat deri në 1400 cm ³ .	Gabim
3345	Me lejedrejtimi të kategorisë BE lejohet të drejtosh kamionë me rimorkio të lehtë.	Gabim
3346	Me lejedrejtimi të kategorisë A lejohet të drejtohen motomjetet që drejtohen me lejedrejtimi të kategorive A1 dhe A2.	Saktë
3347	Me lejedrejtimi të kategorisë A lejohet të drejtohen motorët me kosh.	Saktë
3348	Me lejedrejtimi të kategorisë A lejohet të drejtohen motorët.	Saktë
3349	Me lejedrejtimi të kategorisë A lejohet të drejtohen makina pastrimi të rrugës nën 3,5 tonë.	Gabim
3350	Me lejedrejtimi të kategorisë A, lejohet të drejtohen autovetura të vogla me motor jo më shumë se 500 cm ³ .	Gabim
3351	Me lejedrejtimi të kategorisë B lejohet të drejtohen autoveturat për përdorim vetjak.	Saktë
3352	Me lejedrejtimi të kategorisë B lejohet të drejtohen autokampet me peshë me ngarkesë të plotë deri në 3.5 tonë.	Saktë
3353	Me lejedrejtimi të kategorisë B lejohet të drejtohen makinat teknologjike me peshë me ngarkesë të plotë deri në 3500 kg.	Saktë



3354	Me lejedrejtimi të kategorisë B lejohet të drejtohen edhe motomjete të kategorisë A1, brenda territorit kombëtar, me kusht që mbajtësi i lejedrejtimit të jetë të paktën 21 vjeç.	Saktë
3355	Me lejedrejtimi të kategorisë B lejohet të drejtohen autokarrot me peshën e përgjithshme 3.7 tonë.	Gabim
3356	Me lejedrejtimi të kategorisë B lejohet të drejtohen makinat bujqësore jashtë norme.	Gabim
3357	Me lejedrejtimi të kategorisë B lejohet të drejtohen autobusët me peshë të përgjithshme deri në 3.5 tonë.	Gabim
3358	Me lejedrejtimi të kategorisë B lejohet të drejtohen të gjitha kategoritë e motomjeteve.	Gabim
3359	Me lejedrejtimi të kategorisë B lejohet të drejtohen të gjitha kategoritë e makinave teknologjike.	Gabim
3360	Lejedrejtimi e kategorisë A1, A2, A, B1, B dhe BE është e vlefshme për 10 vjet, kur u jepet personave me moshë deri në 50 vjeç.	Saktë
3361	Lejedrejtimi e kategorive A1, A2, A, B1, B dhe BE është e vlefshme për 5 vjet, kur u jepet personave me moshë mbi 50 vjeç deri në 70 vjeç.	Saktë
3362	Lejedrejtimi e kategorive A1, A2, A, B1, B dhe BE është e vlefshme për 3 vjet, kur u jepet personave me moshë mbi 70 vjeç.	Saktë
3363	Lejedrejtimi e kategorive A1, A2, A, B1, B dhe BE është e vlefshme për 10 vjet, kur u jepet invalidëve.	Gabim
3364	Lejedrejtimi e kategorive A1, A2, A, B1, B dhe BE është e vlefshme për 3 vjet, kur u jepet personave që kanë plotësuar moshën 65 vjeç.	Gabim
3365	Lejedrejtimi e kategorive A1, A2, A, B1, B dhe BE është e vlefshme për 5 vjet, kur personat e kanë kaluar moshën 70 vjeç.	Gabim
3366	Lejedrejtimi i kategorive A dhe B rinovohet nga organi që e lëshon atë.	Saktë
3367	Lejedrejtimi i kategorive A dhe B rinovohet, kur zotëruesi i lejes së drejtimit paraqet certifikatë mjekësore të 6 muajve të fundit, e cila vërteton që është i aftë nga ana psiko-fizike.	Saktë
3368	Lejedrejtimi i kategorive A dhe B rinovohet çdo tri vjet për cilindo që i ka kaluar moshën 70 vjeç.	Saktë
3369	Lejedrejtimi i kategorive A dhe B rinovohet për zotëruenin që plotëson kërkesat fizike e psikike të kërkuara.	Saktë
3370	Lejedrejtimi i kategorive A dhe B rinovohet çdo 10 vjet, për personat nën moshën 50 vjeç.	Saktë
3371	Lejedrejtimi i kategorive A dhe B rinovohet çdo 5 vjet, për personat me moshë mbi 50 deri në 70 vjeç.	Saktë
3372	Lejedrejtimi i kategorive A dhe B rinovohet nga Prefekti i Qarkut.	Gabim
3373	Lejedrejtimi i kategorive A dhe B rinovohet çdo dy vjet mbi moshën 70 vjeç.	Gabim



3374	Lejedrejtimi i kategorive A dhe B rinovohet çdo 5 vjet deri në moshën 50 vjeç, përjashtuar invalidët.	Gabim
3375	Lejedrejtimi i kategorive A dhe B rinovohet çdo tre vjet për moshën mbi 50 deri 60 vjeç.	Gabim
3376	Lejedrejtimi i kategorive A dhe B rinovohet një herë në dy vjet, për ata që janë pajisur për herë të parë me lejedrejtimi në moshën mbi 60 vjeç.	Gabim
3377	Lejeqarkullimi tërhiqet nga organet e kontrollit, kur qarkullon me mjet që i ka skaduar afati i kontrollit teknik.	Saktë
3378	Leje qarkullimi tërhiqet nga organet e kontrollit, kur qarkullohet me mjet që ka certifikatë false të kontrollit teknik.	Saktë
3379	Lejeqarkullimi tërhiqet nga organet e kontrollit, kur drejtuesi nuk sistemon në mënyrë korrekte ngarkesën e mjetit.	Saktë
3380	Lejeqarkullimi tërhiqet nga organet e kontrollit, kur drejtuesi i mjetit lëviz me shpejtësi me të ultë se shpejtësia e lejuar.	Gabim
3381	Lejeqarkullimi tërhiqet nga organet e kontrollit, kur drejtuesi qarkullon me një mjet, pa vendosur rripat e sigurimit.	Gabim
3382	Lejeqarkullimi tërhiqet nga organet e kontrollit, kur mjeti i kalon 40km/orë mbi kufijtë maksimalë të shpejtësisë së lejuar.	Gabim
3383	Lejeqarkullimi tërhiqet nga organet e kontrollit, kur drejtuesit të mjetit i ka përfunduar vlefshmëria e lejedrejtimit.	Gabim
3384	Lejedrejtimi tërhiqet gjatë qarkullimit, kur mbajtësi i saj nuk është paraqitur në zyrat përkatëse për të bërë ndryshimin e vendbanimit.	Saktë
3385	Lejedrejtimi tërhiqet gjatë qarkullimit, kur drejtuesi nuk sistemon në mënyrë korrekte ngarkesën e mjetit.	Saktë
3386	Lejedrejtimi tërhiqet gjatë qarkullimit, kur i ka kaluar afati i vlefshmërisë.	Saktë
3387	Lejedrejtimi tërhiqet gjatë qarkullimit, kur lindin dyshime për mosplotësimin e kërkesave fizike dhe psikike.	Saktë
3388	Lejedrejtimi tërhiqet gjatë qarkullimit, kur drejtuesi po qarkullon me mjet me shpejtësi 10-20 km/orë mbi kufirin maksimal të shpejtësisë se lejuar.	Gabim
3389	Lejedrejtimi tërhiqet gjatë qarkullimit, kur drejton një automjet që nuk ka lejeqarkullimi.	Gabim
3390	Lejedrejtimi tërhiqet gjatë qarkullimit, kur automjeti nuk ka kryer kontrollin teknik.	Gabim
3391	Rivlerësimi i lejedrejtimit bëhet kur lindin dyshime për mosplotësimin e kërkesave fizike dhe psikike.	Saktë
3392	Rivlerësimi i lejedrejtimit bëhet kur krijohen dyshime për aftësitë teknike dhe psiko-fizike të drejtuesit të mjetit.	Saktë
3393	Rivlerësimi i lejedrejtimit bëhet kur zotëruesi i lejedrejtimit ka ndërruar vendbanimin.	Gabim
3394	Rivlerësimi i lejedrejtimit bëhet kur konstatohet se drejtuesi është në drejtim të mjetit pa lejedrejtimi.	Gabim



3395	Rivlerësimi i lejedrejtimit bëhet nëse automjetit të cilin drejton i ka përfunduar vlefshmëria e kontrollit teknik.	Gabim
3396	Lejedrejtimi pezullohet për shkeljeje të përsëritur brenda vitit, kur nuk respektohet e drejta e përparësisë.	Saktë
3397	Lejedrejtimi pezullohet për shkeljeje të përsëritur brenda vitit, kur ai që del nga garazhi, nuk i jep përparësi atyre që kalojnë në rrugë.	Saktë
3398	Lejedrejtimi pezullohet për shkeljeje të përsëritur brenda vitit, kur nuk iu jep të drejtë përparësie mjeteve që qarkullojnë mbi shina.	Saktë
3399	Lejedrejtimi pezullohet për shkeljeje të përsëritur brenda vitit, kur kalohen kufijtë maksimalë të shpejtësisë me jo më shumë se 10 km/orë.	Gabim
3400	Lejedrejtimi pezullohet për shkeljeje të përsëritur brenda vitit, kur nuk janë respektuar kufijtë minimalë të shpejtësisë.	Gabim
3401	Pezullimi i lejedrejtimit bëhet kur drejtuesi i mjetit largohet pa i dhënë ndihmën e tij personit që e ka aksidentuar.	Saktë
